



Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri

**Raport i Vlerësimit Institucional i
Universitetit Bujqësor të Tiranës**

Dhjetor 2016

Përmbajtja

Përmbajtja.....	2
Rreth këtij vlerësimi	1
Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:.....	1
Gjetjet	16
Praktika e mirë	16
Dobësitë	17
Rekomandimet	17
Pohim i veprimeve të ndërmarra	17
Gjykimi	17
Gjykim	27
Standardet për Mësimdhënie, Mësimnxënie, Vlerësim dhe Kërkim janë përmbushur kryesisht. ..	27

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi i përgjithshëm i këtij Vlerësimi Institucional është të vlerësojë shkallën deri ku çdo IAL ka përmbushur Standardet Shqiptare Shtetërore të Cilësisë, që kanë hyrë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është një proces vlerësimi nga ekspertë të jashtëm ku çdo grup vlerësimi përbëhet nga një kombinim ekspertësh britanikë caktuar nga QAA (Quality Assurance Agency – Agjencia e Sigurimit të Cilësisë) dhe ekspertë shqiptarë caktuar nga APAAL (Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm drejtohet nga një ekspert i QAA-së.

Raportet përfundimtare do të shërbejnë jo vetëm për akreditimin institucional, bazuar në shkallën deri ku IAL-ja përmbush Standardet, por edhe do të informojnë IAL-të, qeverinë shqiptare, publikun dhe studentët se si çdo IAL përmbush Standardet. Ky raport ndihmon gjithashtu edhe IAL-në të identifikojë prioritetet për rritjen dhe zhvillimin (proces nëpërmjet të cilit, ofruesit e arsimit të lartë përmirësojnë në mënyrë sistematike cilësinë e ofrimit dhe rrugët në të cilat mbështetet të mësuarit e studentëve).

Standardet Shqiptare Shtetërore të Cilësisë janë grupuar nën pesë Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikës së mirë, rekomandimet, pohimet e veprimeve aktuale dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, së bashku me një gjykim se sa mirë IAL-ja i përmbush Standardet. Gjykimet që mund të përcaktojnë ekspertët janë: Standardet janë përmbushur plotësisht; Standardet janë përmbushur kryesisht; Standardet janë përmbushur pjesërisht; ose Standardet nuk janë përmbushur.

Së fundi, vlerësuesit arrijnë në disa përfundime, duke rekomanduar një gjykim përmbledhës për Këshillin e Akreditimit të APAAL-it. Ky gjykim i përgjithshëm është një nga katër nivelet:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Si pjesë të procesit të përpilimit të raportit, QAA-ja ka dhënë mbështetje me ekspertë për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, për të garantuar që Grupi të mbështesë gjetjet e bëra me materiale faktike dhe prova, si dhe duke redaktuar dhe përmbledhur raportin e plotë më poshtë.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Znj. Mandy Hobart	Kryetare	Nënshkrimi
Profesor Mark Hunt	Anëtar	Nënshkrimi
Profesor Juliana Latifi	Anëtar	Nënshkrimi
Dr Terence Clifford-Amos	Anëtar	Nënshkrimi
Dr. Diturijelsmaili	Anëtare	Nënshkrimi
Dr. Janthia Taylor	Anëtare	Nënshkrimi

Konteksti i këtij vlerësimi

Universiteti Bujqësor i Tiranës u themelua në vitin 1951 dhe është universiteti më i vjetër në Shqipëri. Fillimisht u krijua si Instituti i Lartë Bujqësor dhe më pas u themelua zyrtarisht nga qeveria si Universiteti Bujqësor i Tiranës në vitin 1991. Universiteti përbëhet nga pesë fakultete: Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit; Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit; Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit; Fakulteti i Shkencave Pyjore; dhe Fakulteti i Mjekësisë Veterinare dhe Qendra Kërkimore për Burimet Gjenetike. Universiteti ofron programe të cilat mbështeten nga veprimtaritë e veta kërkimore, veçanërisht në fushat e shkencave biologjike të aplikuara; bujqësisë dhe mjedisit; shkencave ekonomike bujqësore të biznesit; shkencave pyjore; mirëqenien e konsumatorit, shëndetit dhe mbarështimit të kafshëve, bioteknologjisë dhe ushqimit dhe shkencave veterinare. Qendra e Kërkimit për Burimet Gjenetike është gjithashtu pjesë kyçe e Universitetit.

Universiteti ka arritur një gamë të gjerë marrëveshjesh me shoqatat profesionale, përfshirë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe bizneset vendore, për të krijuar dhe promovuar marrëdhënie efektive ndërmjet kërkimit shkencor dhe biznesit dhe interesave të komunitetit. Universiteti ndjek një politikë aktive të pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare me institucione në Evropë dhe më gjerë, të cilat pasqyrojnë misionin dhe vizionin e Universitetit, për të mbështetur dhe përmirësuar prodhimin e ushqimit me cilësi të lartë përmes menaxhimit të tokës, ujit, ajrit dhe teknologjive të gjelbra. Klinika e Mjekësisë Veterinare, Fidanishtja dhe Qendra e Kopshtit Botanik administrohen nga Universiteti, si pjesë e mësimdhënies dhe ofrimit të shërbimeve për komunitetin.

Raporti i përmbledhur

Universiteti Bujqësor i Tiranës është një institucion publik me ambientet dhe ndërtesat e veta në qytetin e Tiranës dhe rreth saj. Universiteti ofron programet e ciklit të parë, të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë në gjuhën shqipe. Universiteti përbëhet nga pesë fakultete dhe një qendër kërkimore: Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit; Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit; Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit; Fakulteti i Shkencave Pyjore; dhe Fakulteti i Mjekësisë Veterinare dhe Qendra Kërkimore për Burimet Gjenetike. Misioni i Universitetit është të mbështesë kërkimet profesionale dhe shkencore dhe zhvillimin e praktikave moderne bujqësore. Në vitin 2015-2016 Universiteti kishte 14.373 studentë, të regjistruar në programet me kohë të plotë dhe me kohë të pjeshme.

Një Raport Vetëvlerësimi u zhvillua nga një grup i Universitetit ku përfshiheshin drejtuesit e lartë, stafi akademik dhe mbështetës dhe një përfaqësues i studentëve. Projektraportet u shpërndanë në një audiencë më të gjerë brenda institucionit, përpara se të finalizoheshin dhe të miratoheshin nga Rektori.

Vizita u zhvillua gjatë tri ditëve më 14, 15 dhe 16 shtator. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga katër ekspertë të lartë vlerësimi të arsimit të lartë nga Mbretëria e Bashkuar dhe dy anëtarë me përvojë të arsimit të lartë nga institucionet shqiptare. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga Menaxheri i Vlerësimit dhe një punonjës për mbajtjen e shënimeve që u sigurua nga APAAL-i. Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion Raporti i Vetëvlerësimit dhe paketa e dokumentacionit mbështetës, tetë javë përpara vizitës së vlerësimit, të plotësuar më vonë me dokumentacion shtesë që u kërkua. Në tërësi, rreth 193 dokumente i mundësuan grupit të njihet me strukturën, politikën, procedurat e drejtimit dhe administrimit dhe natyrën e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore të ndërmarrë nga Universiteti. Dokumentet përfshinin Statutin e Universitetit, rregulloret akademike, raportet vjetore, procedurat e pranimit dhe orientimit, listën e marrëveshjeve dhe memorandumëve të jashtme, shembuj të informacioneve të programit dhe dokumentacion të diskutimeve të mbledhjeve.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me drejtuesit e lartë, studentët, lektorët, stafin administrativ dhe atë mbështetës, si dhe partnerë të jashtëm dhe punëdhënës gjatë vizitës së vlerësimit. Diskutimi mbështeti sqarimin e procedurave, përgjegjësi dhe pikëpamjeve. Në të gjitha mbledhjet u mbajtën shënime. Si pjesë e një turi në kampusin kryesor, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi bibliotekën, auditorët, laboratorët dhe zyrat, dhe ndoqën një demonstrim të sistemeve informative elektronike të Universitetit.

Universiteti i përmbush plotësisht standardet e cilësisë për Organizimin dhe Menaxhimin e tij.

Struktura e efektshme e organizimit dhe zgjedhjet transparente për postet e larta tregojnë strategjinë kolegjiale të Universitetit. Përgatitja dhe vlerësimi i punës praktike dhe marrëveshja me Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU) dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) mbështesin zhvillimin e kurrikulave dhe nxitjen e punësueshmërisë së studentëve dhe përbëjnë praktikë të mirë. Plani Strategjik informon dhe udhëzon zhvillimet e ardhshme që përfshijnë rritjen e qendrës Alumni – të ish-studentëve, e cila duhet të vazhdojë të zhvillohet. Planet e veprimtari që lidhen me raportet kryesore të institucionit do të mbështesin më tej monitorimin dhe vlerësimin e nismave të reja dhe vlerësimin e ecurisë.

Përgjegjësitë për menaxhimin e burimeve i përmbushin kryesisht standardet e cilësisë. Praktikën e mira identifikohen në: angazhimin me projekte të jashtme, për të përmirësuar

bazën e njohurive; zhvillimin e një sistemi informacioni të integruar, për të përmirësuar komunikimin; dhe puna e transferimit të njohurive veçanërisht në fushën e tokës, prodhimit të ushqimit dhe cilësisë së ujit. Mbështetja e mëtejshme për aktivitetet sociale do të ndihmonte në nxitjen e integritit social të studentëve dhe realizimi i anketimeve do të informonte zhvillimin e shërbimeve, për të plotësuar nevojat e tregut vendor dhe rajonal. Përshkrimet e punës nuk janë të disponueshme për të gjitha rolet/pozicionet, dhe Grupi rekomandon që Universiteti ta trajtojë këtë dobësi.

Standardet për menaxhimin e Kurrikulës përmbushen plotësisht. Misioni i Universitetit është i përqendruar në një program mësimor, që i shërben kërkesave kombëtare për të nxjerr të diplomuar të orientuar në arsimin profesional në bujqësi, ekonomi bujqësore, ushqim dhe mjedis. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi praktika të mira në përgatitjen e studentëve për praktikën profesionale, në punën e përbashkët akademike për nivelin Master me institucionet evropiane dhe në tërësinë e raporteve të vetëvlerësimit të fakultetit që mbështesin vetëreflektimin dhe ngritjen e programit të Universitetit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon se Universiteti zhvillon një qasje të qëndrueshme në analizën e të dhënave të punësueshmërisë, për të ndihmuar zhvillimin e ardhshëm të kurrikulës dhe përgatitjen e studentëve për punësim.

Standardet për menaxhimin e Mësimdhënies, Mësimnxënies, Vlerësimit dhe Kërkimit janë përmbushur kryesisht. Praktikën e mira përfshijnë angazhimin e stafit dhe studentëve në një sërë projektesh dhe botimesh kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe kërkime që mbështesin zhvillimet bujqësore dhe ekologjike në lidhje me interesat ekonomike kombëtare. Angazhimi në konferenca ndërkombëtare që nxisin kërkimin, gjithashtu përbën praktikë të mirë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që cilësia e laboratorëve të mësimdhënies të përmirësohet, për të mbështetur mësimin e bazuar në praktikë dhe që çështjet e ngritura nga Anketimi i Studentëve për përvojat e tyre të vlerësimit të hulumtohen. Gjithashtu i rekomandohet universitetit për të promovuar profilin e vet të kërkimit, në mënyrë që të shtojë mundësitë për stafin dhe studentët.

Universiteti i përmbush plotësisht standardet për mbështetjen e nevojave të studentëve. Praktikën e mira përfshijnë: një proces të efektshëm pranimit dhe një sistem të menaxhimit të ankesave; informacion mbi studime jashtë vendit ofruar nga Departamenti për Informimin, Orientimin dhe Karrierën e Studentëve dhe nga Zyra e Karrierës së Studentëve; burimet e bibliotekave; dhe panairët vjetore të punësimit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi punën e konsoliduar të Departamentit të Informacionit, Orientimit dhe Karrierës së Studentëve dhe Zyrës së Karrierës së Studentëve, që mbështesin studentët për t'u inkuadruar në Universitet dhe vlerën e orientimeve dhe instruktiveve në vitin e parë, për të ndihmuar studentët në arritjen e këtij qëllimi.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se Standardet e Cilësisë janë përmbushur plotësisht në tre fusha dhe janë përmbushur kryesisht në dy fusha.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Përgatitja, menaxhimi dhe vlerësimi i efektshëm i praktikave profesionale që mbështesin punësueshmërinë e studentëve (pika 1.10)

- Bashkëpunimi me MBZHRAU dhe Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, që mbështet zhvillimin e kurrikulës dhe punësimin e studentëve dhe pasqyron orientimin profesional të UBT-së (pika 1.14)
- Angazhimi i Universitetit në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, duke përfshirë shkëmbimet e stafit, që mbështesin mobilitetin e stafit dhe zhvillimin e ekspertizës (pika 2.3)
- Zhvillimi dhe zbatimi i sistemeve të integruara të informacionit ndihmon Universitetin të funksionojë si një komunitet dhe të mbështesë përdorimin e efektshëm të burimeve (pika 2.10)
- Shërbimet e specializuara mbështesin transferimin e njohurive dhe zhvillimin e menaxhimit të zgjeruar të sistemeve (pika 2.13)
- Udhëzimet për Programin e Praktikës Profesionale u ofrojnë studentëve informacion për të mbështetur përvojën e tyre të punës dhe zhvillimin e aftësive praktike (pika 3.4)
- Masteri i Përbashkët Ndërkombëtar në Mjekësinë e Bimëve ilustron vlerën e kërkimit ndërdisiplinor që Universiteti ndërmerr me institucionet e tjera evropiane, për të krijuar fondin e njohurive dhe praktikës (pika 3.8)
- Përmbledhja e raporteve të vetëvlerësimit të Fakultetit që mbështesin vlerësimin dhe zhvillimin e mësimdhënies (pika 3.12)
- Kontributi i stafit të kërkimit shkencor në projekte dhe studime që mbështesin zhvillimet bujqësore dhe ekologjike, që lidhen me interesat ekonomike kombëtare (pika 4.8)
- Angazhimi i Universitetit në konferenca ndërkombëtare që promovon fushat kyçe të kërkimit (pika 4.9)
- Përfshirja e stafit dhe studentëve të universitetit në një numër të madh të projekteve dhe botimeve kombëtare dhe ndërkombëtare dhe kontributi i tyre në to (pika 4.9)
- Procesi i qartë dhe i drejtë i pranimin në Universitetin i cili mbështet aplikimet e studentëve (pika 5.1)
- Mbledhja e komisioneve ad hoc sipas nevojës, për të shqyrtuar ankimimet e pranimeve dhe për të konfirmuar të dhënat e studentëve për pranimin në programet e studimit (pika 5.3)
- Departamenti i Informacionit, Orientimit dhe Karrierës së Studentëve dhe Zyrat e Karrierës së Studentëve ofrojnë informacion rreth mundësive për studime jashtë vendit, veçanërisht lidhur me projektin Erasmus (pika 5.7)
- Gama e gjerë të librave dhe revistave në dispozicion në gjuhën shqipe dhe gjuhë të tjera, në të cilat kanë akses studentët (pika 5.10)
- Panairë vjetore të punësimit që i sjellin studentët në kontakt me tregun e punës dhe mbështesin punësueshmërinë (pika 5.13).

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesa e përshkrimit të punës për çdo funksion apo pozicion në Institucion (pika 2.7)
- burime të kufizuara në laboratorët e mësimdhënies (pika 4.1)
- zbatimi i procedurave të vlerësimit të studentëve dhe *feedback-ut* (reagimi) (pika 4.4)
- zhvillimi i mëtejshëm i promovimit të profilit të kërkimit të Universitetit (pika 4.11).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme, Universiteti:

- të vazhdojë me zhvillimin e përshkrimit të vendeve të punës për të gjitha pozicionet (pika 2.7)
- të adresojnë cilësinë e laboratorëve të mësimdhënies, për të mbështetur mësimin e bazuar në praktikë (pika 4.1)
- të hetojë çështjet e vlerësimit të studentëve të ngritura nga Anketimi i Studentëve, për të siguruar më tej proceset e vlerësimit (pika 4.4)
- të promovojë profilin kërkimor të Universitetit për të shtuar mundësitë për stafin kërkimor dhe studentët e tij (pika 4.11).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon që veprimet e mëposhtme po ndërmerren aktualisht:

- Zhvillimi i Qendrës së Karrierës dhe Alumni dhe rritja e saj, në mbështetje të punësimit të studentëve (pika 1.11)
- Përparimi i informacionit dhe analizës së të dhënave të punësimit të të diplomuarve, për të siguruar që programet e studimit mbeten të rëndësishme për nevojat e ardhshme të punësimit (pika 3.14)
- Konsolidimi i dy zyrave (Zyra për Orientimin, Informimin e Studentëve dhe Zyra për Zhvillimin e Karrierës së Studentëve) mbështet menaxhimin koherent dhe sigurimin e informacionit për studentët e rinj (pika 5.1)
- Vlera e manualeve të vitit të parë të përgatitur nga Zyra e Karrierës së Studentëve për të ndihmuar studentët e rinj të inkuadrohen dhe akomodohen në Universitet (pika 5.1).

Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht.
- 2 Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht.
- 3 Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.
- 4 Standardet për mësimdhënie, Mësimnxënie, Vlerësim dhe Kërkim janë përmbushur kryesisht.
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht.

Gjykimi i përmbledhur

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon Këshillit të Akreditimit që në Universitetin Bujqësor të Tiranës standardet shtetërore të cilësisë janë përmbushur kryesisht.

Raport i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe menaxhimi i tij

1.1 Universiteti arrin të provojë se zotëron mekanizma të qarta për të mbështetur funksionet e organizimit dhe menaxhimit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se: Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) vepron si institucion publik i arsimit të lartë, sipas 85 neneve të statutit të tij të brendshëm ligjor. **[118, Statuti i UBT-së]** UBT-ja është në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 104. **[1 RVV - Raporti i Vetëvlerësimit, fq.1; Kapitulli III Standardi I.1]**

1.2 Organet e brendshme të administrimit janë Senati Akademik, Rektorati, Bordi i Drejtorëve, Këshilli i Etikës dhe Këshillat e Fakultetit. Autoritetet drejtuese të Universitetit përbëhen nga Rektori, Dekanët dhe Përgjegjësitë e Departamentit. **[118 Statuti i UBT-së, Neni 9]** Rregullorja e Studimeve Universitare përcakton një kornizë akademike funksionale koherente, **[100 Rregullore e Studimeve të Universitetit]** dhe një diagram e qartë dhe e dobishme ilustron rregullimet e organizimit dhe të menaxhimit. **[60 Organigrama e UBT-së]** Përpos kësaj, UBT-ja ka rregullore të brendshme funksionale në nivelin e fakultetit. **[98, Rregullorja e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit]** Pesë fakultete dhe 21 departamente funksionojnë në frymën e lirisë akademike. **[118 Statuti i UBT-së, nenet 28, 5]** Këshillat e secilit fakultet janë organe vendimmarrëse. Në këto këshilla përfaqësohen stafi akademik, stafi mbështetës dhe studentët. Këto organe kolegjiale veprojnë në emër të departamenteve akademike në vendimet e tyre për programet, shpërndarjen e burimeve të fakultetit dhe fushat e tjera të rëndësishme të veprimit, të tilla si kurrikula, planet mësimore, programet kërkimore, bashkëpunimi në nivel kombëtar. Për shembull, në vitin 2015, Këshilli i Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit miratoi programin e studimit në fushën e vlerësimit të pronës së paluajtshme për tokën bujqësore, pylltarinë, kullotat dhe tokën joproduktive dhe e dërgoi propozimin në Senat. **[118 Statuti i UBT-së; 140 Vendimi i Këshillit të Fakultetit; Kapitulli III Standardi 2.3]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka konstatuar se Universiteti ka struktura të detajuara dhe efektive të menaxhimit organizativ. Universiteti besonte se ligji i ri do të ndihmonte në përparimin e prioritetëve të tij në mësimdhënien, kërkimin, punësimin dhe transferimin e njohurive. **[M1 Grupi i Vetëvlerësimit; Takimi 2 Rektori; Kapitulli III Standardi I.2]**

1.3 Universiteti e konsideron statutin e brendshëm si "organizëm të gjallë" dhe i përgjigjet kuadrit të tij ligjor, institucional dhe socio-ekonomik. Ndryshimet e vazhdueshme të statutit institucional u përmendën si dëshmi e këndvështrimeve të reja, ndikimit dhe domosdoshmërisë për ndryshim. **[150, Vendim për ndryshimin e Rregullores së Brendshme të Statutit të UBT; Stafi i lartë drejtues i M3]** Stafi i lartë drejtues i Universitetit deklaroi se kohët e fundit ligji i ri kishte nxitur ndryshimet në statutin e brendshëm. Ndikimi i ligjit të ri iu referohet gjithashtu pranimeve dhe stafit mbështetës. **[Stafi i lartë drejtues M3; M9 Pranimet dhe Stafi Mbështetës; Kapitulli III Standardi I.2]**

1.4 Efikasiteti në menaxhimin financiar arrihet kryesisht nëpërmjet komisionit të ngritur nga zyra e Rektorit për hartimin e buxhetit, i cili, pas përfshirjes së departamenteve dhe fakultetit, i dorëzohet përfundimisht Senatit për miratim. **[62, Plani i Veprimit për Hartimin e Buxhetit; 147 Miratimi i Projektbuxhetit të Mesëm; M 3 Stafi i lartë drejtues]** Rektorati është gjithashtu përgjegjës për hartimin e planit afatgjatë të zhvillimit, për të cilin është ngritur një grup pune i UBT-së. **[1 RVV, fq.6]** Plani i ri strategjik për 2016-2025 ka objektiva dhe mjete për të arritur rezultatet e pritshme sipas misionit dhe qëllimit të UBT-së, në përputhje me prioritetet kombëtare. **[61 Strategjia e Zhvillimit të UBT, 2016-2025; M2]**

Rektor] Si një mjet në funksion të zgjerimit të praktikës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjithashtu sugjeron zhvillimin e planeve të veprimit të lidhura me raportet kyçe, duke përfshirë raportet kryesore të institucionit, të cilat mund të përmirësojnë vlerësimin e progresit dhe zhvillimin e ardhshëm.

1.5 Këshilli i Administrimit kontrollon të gjitha funksionet ekonomike dhe administrative, duke përfshirë çështjet që kanë të bëjnë me nivelin e pagave për stafin akademik dhe joakademik si dhe tarifën e studimit. **[118 Statuti i UBT-së, Neni 14]** Këshilli i Etikës ka rregulloren e vet (23 nene) që ka të bëjë me sjelljen e përgjithshme të të gjithë stafit. **[96 Rregullore e Këshillit të Etikës]** Këshillat për secilin prej pesë fakulteteve mbikëqyrin punën e fakulteteve, departamenteve dhe programeve të tyre akademike, **[118, Statuti i UBT-së, nenet 34-36]** dhe secili fakultet ka një Këshill të Profesorëve, funksionet e të cilit janë: të miratojë komisionet për përzgjedhjen e përgjegjësve të grupeve mësimore dhe kërkimore; të marrë përgjegjësinë për programet e doktoratës; dhe të bëjë propozime për kandidatët që kërkojnë tituj akademikë. **[118, Statuti i UBT Neni 26; 97, Rregullorja e Këshillit të Profesorëve, nenet 8-10]** Numri minimal i profesorëve për funksionimin e Këshillave është shtatë. Dekanët, si titullarë të fakulteteve, zgjidhen në mënyrë demokratike për një mandat katërvjeçar. **[118, Statuti i UBT-së, neni 37]** Po ashtu, rektori dhe përgjegjësitë e departamenteve janë zgjedhur gjithashtu në mënyrë demokratike. **[M 3 Staf i lartë drejtues]** Studentët, stafi akademik dhe joakademik mund të marrin pjesë në zgjedhjet për Dekanin. Në zgjedhjet për postet e larta ka korrektësi dhe transparencë, në përputhje me rregullimin e zgjedhjeve të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. **[Kapitulli III Standardi I.2]**

1.6 Diskutimi konstruktiv në të gjithë institucionin është një aktivitet i vlefshëm dhe Senati Akademik dhe Këshillat e Fakultetit mbledhen rregullisht çdo semestër, sipas kalendarit me datat e publikuara për mbledhjet e Senatit Akademik. **[118, Statuti i UBT Neni 359, Kalendar i Takimeve të Senatit]** Mbledhjet e departamenteve gjithashtu organizohen rregullisht. **[Stafi i lartë drejtues M3; Kapitulli III Standardi I.3]** Ekzistojnë disa mekanizma të brendshme që sigurojnë funksionin efikas dhe monitorimin e Universitetit brenda kufijve autonom të tij, duke përfshirë: funksionet e menaxhimit të dy zëvendës-reaktorëve dhe dy zëvendës-dekanëve; Sektori i Kurrikulës, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional; Qendra Alumni; njësitë speciale, të cilat përfshijnë: Institutin e Burimeve Gjenetike të Bimëve; Institutin për Studime Ekonomike dhe Transferimin e Dijes; Qendrën Kombëtare të Trajnimit të Bujqësisë dhe së fundi, Sektorin e Projekteve. **[118, Statuti i Pjesëve të Autorit: 17, 20 dhe 31 para. f; neni 28; neni 29]** Kancelari i UBT-së mbikëqyr të gjithë legjislacionin. **[Neni 20]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konfirmoi që Universiteti monitoron efektivitetin e tij brenda kufijve të vet autonom. **[Kapitulli III Standardi I.4]**

1.7 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjithashtu konstatoi se plani strategjik i UBT-së është i përafëruar mirë me vizionin e institucionit. UBT-ja ka një vizion strategjik të angazhimit me partnerët rajonalë dhe evropianë dhe po punon drejt një qëllimi të parashikueshëm të integritetit global të arsimit të lartë bujqësor. **[61, Strategjia e Zhvillimit të UBT-së, 2016-2025]** Strategjitë e kërkimit, zhvillimi i stafit dhe i studentëve, sigurimi i cilësisë dhe ndërkombëtarizimi janë ndër prioritetet e shprehura në strategjinë dhe planifikimin e UBT-së. **[10 Marrëveshje me Berufsbildungswerk në Mynih; 11 Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin Bujqësor të Kinës Pekin; 51 Lista e projekteve në 3 vitet e fundit]** Ka gjithashtu një dokument të veçantë që përshkruan plotësisht strategjinë e kërkimit të UBT-së. **[63 Strategjia e Kërkimit Shkencor të UBT; Kapitulli III Standard I.5]**

1.8 Raporti vjetor i UBT-së përgatitet dhe shqyrtohet nga një sërë nivelesh të zyrtarëve të lartë të institucionit dhe i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Raporti, i cili shqyrton

procesin e mësimdhënies, siguron një analizë gjithëpërfshirëse të shpërndarjes, dhe diskutohet në të gjithë institucionin. **[7 Raporti i Analizës së Procesit Mësimor, 2014-2015; M3 Stafi i lartë drejtues]** Përveç kësaj, misioni dhe qëllimi i UBT-së ka një profil të qartë për të gjitha njësitë e veta funksionale, **[118 Statuti i UBT-së, Neni 8]** duke nxitur debatin dhe duke deleguar vendimmarrjen, veçanërisht në nivelin e Këshillit të Fakultetit, të cilat janë organe kolegjiale të mëdha aktive. **[RVV, fq.8; 118 Statuti i UBT-së, nenet 34, 36]** Organet e institucionit gjithashtu punojnë kolegjialisht, përfshirë marrjen e vendimeve për ecurinë dhe mirëqenien e të gjithë institucionit akademik dhe administrativ. **[118 Statuti i UBT-së, nenet 3-4; 34, Vendimi i Këshillit të Fakultetit FAE; RVV, Përfundimi dhe Vlerësimi, fq.14; Kapitulli III Standardi I.6]**

1.9 Qëllimi i Universitetit është arritja e përsosmërisë në tërësinë e punës së tij në fushat universitare dhe pasuniversitare të studimit, kërkimit dhe trajnimit, nëpërmjet një sërë sipërmarrjesh dhe aktiviteteve që lidhen me bujqësinë dhe ushqimin. Universiteti ka një prioritet të përcaktuar, që studentët duhet të bëhen qytetarë të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë. **[1, RVV, fq. 4, 10; M2 Rektori]** UBT-ja ka një faqe zyrtare. **[www.ubt.edu.al; M9 Pranimet dhe Stafi Mbështetës; Kapitulli III Standardi III.1]**

1.10 Universiteti është i angazhuar në mënyrë aktive me dinamikën rajonale dhe kombëtare të zhvillimit të biznesit dhe përdor informacion, për të monitoruar kurrikulat dhe për të filluar programe të reja studimi. **[M2 Rektori; Stafi i lartë drejtues M3; Të dhënat e profilit të institucionit; 43 Lista e marrëveshjeve të biznesit]** Për të mbështetur natyrën e veçantë dhe profesionale të kurrikulës së saj në arsimin e lartë shqiptar, UBT-ja është e ndjeshme ndaj nevojave dhe kërkesave të ekonomisë vendore dhe varësisë së saj nga bujqësia dhe produktet ushqimore. **[M5 punëdhënësit dhe partnerët e jashtëm; Stafi i lartë drejtues M3; Stafi Akademik M7; 193 Anëtarësia në Këshillin e Kurrikulës; Kapitulli III Standardi 3.1]** Partnerët e jashtëm dhe punëdhënësit konfirmuan se studentët në stazh dhe ata që gjejnë punë, kanë njohuri të mira teorike dhe janë të vendosur për të fituar njohuri dhe përvojë praktike. Studentët e stazhit kanë sugjeruar gjithashtu aspekte për përmirësim në mbështetje të bizneseve me të cilët kanë punuar. **[M5 - Punëdhënësit dhe partnerët e jashtëm; Studentët M4 & M8; 191 dosjet e Praktikës Profesionale]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u njoh me marrëveshjet formale të detajuara, për lehtësimin konkret dhe specifik të nevojave të studentëve, për instruktimin dhe mbikëqyrjen, si dhe përgatitjen e ndërmarrë nga Universiteti. Në përgjithësi, kujdesi i duhur i treguar për praktikën profesionale, menaxhimin dhe vlerësimin e shëndetit dhe sigurisë, e bindën Grupin e Vlerësimit që ta konsideronte këtë strukturë jashtëzakonisht të mirëzhvilluar si një **praktikë të mirë. [Kapitulli III Standardi III.1 dhe Standardi III.3]**

1.11 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka gjetur dëshmi të një Qendre për Karrierën dhe Alumni në zhvillim, për të mbështetur angazhimin në lidhje me punësueshmërinë. **[148 Vendimi i Senatit të UBT-së për themelimin e Qendrës për Karrierën dhe Alumni; 46 Lista e Marrëveshjeve me Bizneset dhe Institucionet Publike për Praktikën Profesionale të Studentëve, Qendrën e Karrierës dhe Alumni; Mbledhja 7 Stafi akademik dhe pedagogët përgjegjës]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohoi** zhvillimin e Qendrës së Karrierës dhe për Alumni dhe forcimin e saj në mbështetje të punësimit të studentëve. Procesi i krijimit të portalit ndërveprues të Qendrës për Karrierën dhe Alumni është në fazat e tij fillestare. Pa përfundimin e këtij procesi, do të kishte rrezik për përmbushjen e *Standardit III.1.*

1.12 Bashkëpunimi rajonal është kryesisht me zonat shqipfolëse të Ballkanit dhe Evropën Lindore dhe ka bashkëpunim të konsiderueshëm kombëtar. **[RVV, fq.11; 47 Lista e marrëveshjeve të UBT-së me institucionet e huaja]** Universiteti ndërkombëtar

bashkëpunon me më shumë se 40 institucione të arsimit të lartë dhe gjithashtu bashkëpunon me shumë organizata dhe rrjete ndërkombëtare. **[61 Strategjia e Zhvillimit të UBT-së 2016-2025]** UBT-ja ka formalizuar marrëveshje për diploma të përbashkëta ose të dyfishta me Italinë, Serbinë, Greqinë, Kosovën, Bullgarinë dhe Maqedoninë. **[12 Marrëveshje Bashkëpunimi për Njohjen e Ndërsjellë të Diplomës Master në Mjekësinë e Bimëve IPM Programi Evropian; 76 Protokoll i zbatimit të një diplome të përbashkët midis Universitetit të Peruxhias dhe UBT-së; Mbledhja e 3 Stafit të Lartë drejtues]** Një sërë njësish bazë kërkimore të Universitetit, përfshirë Institutin e Bimëve dhe të Burimeve Gjenetike, Institutin e Studimeve Ekonomike dhe Transferimit të Njohurive dhe Qendrën Kombëtare të Trajnimit të Bujqësisë janë të suksesshëm në marrjen e fondeve evropiane. **[1 RVV, fq. 8-9; Statuti i UBT-së, Neni 29; Lista e projekteve kërkimore; Kapitulli III Standardi III.2]**

1.13 Puna me institucionet e jashtme (e tjera) përfshin marrëveshjet e bashkëpunimit me biznesin e vogël dhe të mesëm, organizatat qeveritare kombëtare, kompanitë private, institucionet kërkimore shkencore dhe ato me Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRUA) dhe Drejtoritë Rajonale. Praktikrat profesionale zhvillohen nga një në tre muaj në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (AKU). **[RVV, fq. 12-13; 43 Lista e Biznesit me marrëveshje bashkëpunimi; 55 Marrëveshja e Bashkëpunimit me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit]** Marrëveshjet në thelb janë ndërtuar rreth zhvillimit të aftësive dhe interesave, të cilat i përshtatin studentët për vende të veçanta pune, për shembull, për një diplome të bazuar në prodhimin e lëngut të frutave. Studentët e tjerë kërkojnë mundësi tregtare, për shembull, në sigurime dhe në teknologji. Studentët përfitojnë nga të mësuarit rreth aplikimeve teknologjike. Gjithashtu shfrytëzohen edhe Qendrat Kombëtare të Trajnimit. **[M5 - Partnerët e jashtëm, këshilltarët dhe punëdhënësit; Mbledhja 7 - Stafi akademik dhe pedagogët përgjegjës; Kapitulli III Standardi III.3]**

1.14 Memorandumi i Marrëveshjes së Universitetit me MBZHRUA informon zhvillimin dhe prezantimin e programeve studimore të lidhura me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social dhe zhvillimet praktike. **[43, Lista e Bizneseve që kanë Marrëveshje Bashkëpunimi; 46, Lista e marrëveshjeve me bizneset dhe institucionet publike; 55, Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet UBT-së dhe AKU-së; 54, Marrëveshja e Bashkëpunimit me MBZHRUA]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konsideroi bashkëpunimin me MBZHRUA dhe AKU, i cili mbështet zhvillimin e kurrikulave dhe punësimin e studentëve dhe pasqyron orientimin profesional të UBT-së, si **praktikë e mirë. [Kapitulli III Standardi III.3]**

1.15 Mobiliteti evidentohet dhe mbështetet, nëpërmjet marrëveshjeve ndërkombëtare midis Universitetit dhe institucioneve të huaja të arsimit të lartë, si dhe nëpërmjet angazhimit me programe ndërkombëtare si CEEPUS dhe ERASMUS +. Deri më sot, këto kanë përfshirë kryesisht stafin akademik, ndërsa mobiliteti i studentëve është më i kufizuar. Megjithatë, Universiteti ka ndjekur një politikë për integrimin e studentëve të huaj nga vendet fqinjë, përmes programit CEEPUS, si prioritet nga Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, për ata studentë që mund t'i zhvillojnë studimet e tyre në gjuhën shqipe. **[83 Programi i Përbashkët i Doktoratës në Menaxhimin e NVM-ve për WBC; 127 Tempus, Përdorimi i burimeve vendore; 128 Tempus, Zhvillimi i Informacionit; 14 Zhvillimi i Aktiviteteve të Misionit të Tretë në Universiteteve Shqiptare; 72 Projekti CEEPUS CII-SK-0505; 32 Marrëveshja ndër-institucionale, 2014-2020; 73 Projekti CEEPUS Rrjeti CEEPUS CII-HU-0003; 74 Rrjeti i Projekteve CEEPUS CII-PL-0114; Kapitulli III Standardi III.4]**

1.16 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykon se Universiteti i përmbush standardet e cilësisë për menaxhimin dhe organizimin e tij. Struktura organizative e qartë dhe efektive është në përputhje me procedurat e zgjedhjeve për postet e larta. Përgatitja dhe vlerësimi i punës praktike dhe marrëveshja me MBZHRUA dhe mbështetja e AKU-së, duhet të mbështesin zhvillimin e kurrikulave dhe të nxisin punësimin e studentëve, si edhe të identifikohet si një **praktikë e mirë**. Plani Strategjik informon dhe udhëzon zhvillimet e ardhshme, që përfshijnë rritjen e Qendrës së Alumni, të cilën Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e pohon si një zhvillim kyç në proces dhe burim kyç për Universitetin. Planet e veprimit të lidhura me raportet kyçe të institucionit do të mbështesin më tej monitorimin dhe vlerësimin e nismave të reja dhe vlerësimin e ecurisë.

Gjetjet

Praktikë e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Kujdesin e duhur dhe vlerësimin e praktikave që mbështesin punësimin e studentëve (pika 1.10)
- Bashkëpunimi me MBZHRUA dhe Autoritetin Kombëtar të Ushqimit i cili mbështet zhvillimin e mësimdhënies dhe nxit punësimin e studentëve dhe pasqyron orientimin profesional të UBT-së (pika 1.14).

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi dobësi në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon se veprimet e mëposhtme po ndërmerren aktualisht:

- Zhvillimi i Qendrës së Karrierës dhe Alumni dhe forcimi e saj, që mbështet punësimin e studentëve (pika 1.11).

Gjykim

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht.

Fusha e vlerësimit 2: Burimet

2.1 Universiteti ka një politikë të hapur për punësimin dhe rekrutimin e stafit që përmbush kërkesat standarde. Universiteti publikon organigramën e tij të miratuar nga Rektori, e cila ndryshohet nga Këshilli Administrativ sipas nevojës. **[120 Organigrama; 95 Rregullorja e Këshillit Administrativ të UBT-së]** Kriteret e punësimit për stafin akademik me kohë të plotë, me kohë të pjesshme, të kontraktuar dhe të ftuar, hartohen në përputhje me kërkesat ligjore. **[34 Kontrata e punës me përshkrimin e punës; 35 Kontratë pune për lektorët e ftuar; Stafi i lartë drejtues M3; Kapitulli III Standardi IV.1]**

2.2 Universiteti ka hartuar procedura për rekrutimin e stafit akademik dhe joakademik. **[145 Vendimi Nr. 11; 155 Vendimi i Rektoratit Nr. 48]** Vendet e lira të punës miratohen nga Rektori dhe shpallen, përmes buletinit të njoftimeve publike si dhe në faqen e internetit. **[59 Ofertë Pune Nr. 1538 Prot., dhe kriteret; M9 Stafi Administrativ]** Universiteti menaxhon një proces të hapur, konkurrues dhe objektiv për të gjitha emërimet, të cilat janë shqyrtuar kohët e fundit. **[61 Strategjia e Zhvillimit; 27 www.ubt.edu.al/sq/article/organigrama-0; 120 Organigrama; 144 kontrata e punës; M9 Stafi Administrativ]** Procesi i përzgjedhjes bazohet në kriteret parësore, të preferuara dhe plotësuese të cilat janë vlerësuar me pike, dhe u jepet përparësi kandidatëve me kualifikime të fituara jashtë vendit. Kërkohej dëshmi penaliteti për të gjithë punonjësit. **[129 Urdhri Nr. 102; 136 Vendimi Nr. 15; i Senatit Akademik të UBT-së, 155 Vendimi i Rektoratit Nr. 48]** UBT-ja, në mënyrë aktive ndjek një politikë të hapur të rekrutimit e cila është e drejtë dhe transparente. Kontratat e përkohshme lëshohen për pedagogë dhe praktikantë, që punojnë edhe për organizata të tjera. **[34 Kontrata e punës me përshkrimin e punës; Kapitulli III Standardi IV.1]**

2.3 Universiteti është i përfshirë në koordinimin për projekte shkencore ndërkombëtare të cilat mundësojnë lëvizjen e stafit akademik dhe rritjen e aftësive akademike dhe nivelin e ekspertizës. **[64 Plani vjetor dhe strategjik; Lista e projekteve]** Komiza e marrëveshjeve me universitetet e huaja dhe qendrat kërkimore i mundëson stafit të ndërmarrë vizita shkëmbimi dhe të studiojë për kualifikime të mëtejshme jashtë vendit, gjë që është tipar i praktikës së mirë. **[47 Lista e marrëveshjeve e UBT-së me institucionet e huaja; Stafi i lartë drejtues M3; Kapitulli III Standardi IV.3]**

2.4 Planet e trajnimit të stafit janë zhvilluar në përputhje me politikat e Universitetit. Nxitet pjesëmarrja në aktivitetet në universitetet perëndimore, dhe përvoja kërkimore jashtë vendit është një kërkesë ligjore dhe kusht për të marrë titullin "Profesor". **[5 Marrëveshje ndërmjet universitetit dhe stafit akademik që kryejnë e studimeve të doktoratës jashtë vendit; 46 Vendimi i Jurisë së Fakultetit për Promovimin e titullit "Profesor"]** Vendimet e Promovimit shqyrtohen nga Komisioni Vlerësues i cili përbëhet nga shtatë anëtarë, duke përfshirë një përfaqësues nga një universitet të huaj. **[146 Vendimi i Jurisë së Fakultetit për Promovimin e Titullit "Profesor", 187 tituj të dhënë]** Përvoja ndërkombëtare e fituar nga stafi informon dhe mbështet zhvillimin e stafit. Gjithashtu nxitet mobiliteti për studime të doktoratës në institucionet partnere. **[17 RVV; M8 studentët pasuniversitarë]** Ftohen edhe Profesorë Emeritus, që mbajnë leksione, kur ata janë ende të angazhuar në jetën akademike. **[35 Kontrata e punës për lektorët e ftuar (shembull); Kapitulli III Standardi IV.3]**

2.5 UBT-ja organizon aktivitete sociale, duke përfshirë festat /ceremonitë e lidhura me çmime, promovime librash dhe daljet në pension. Gjithashtu, janë organizuar një numër i kufizuar aktiviteteve shoqërore, si klube dhe shoqata studentore, por ato kryesisht mbështeten tek individët për të ndërmarrë ndonjë iniciativë. **[M4 Takim me studentë; M8**

studentët pasuniversitarë] Një përkrahje më proaktive nga Universiteti për aktivitetet sociale, si klubet dhe shoqatat studentore, do të zgjerojnë përvojën e studentëve dhe integrimin social. **[Kreu III Standardi IV.4]**

2.6 Universiteti ka një politikë për vështirësitë dhe dekanët mund të paraqesin rastin e stafit që kërkon ndihmë financiare si rezultat i sëmundjes së rëndë, operacionit ose rrethanave të tjera serioze. **[133 Urdhri nr. 5, datë 11.01.2016 i Rektorit të UBT; 134 Urdhri Nr. 92, datë 02.06.2015 T]** Siguria në vendin e punës dhe sigurimi i jetës janë parë gjithashtu si aspekte të rëndësishme të mirëqenies sociale. **[135 Urdhri Nr. 132; Kapitulli III Standardi IV.4]**

2.7 Universiteti përdor kontrata individuale të punës. **[34 Kontratë pune me përshkrim të vendit të punës nr. 3; 36 Punësimi nr. 176; 35 Kontrata për lektorët e ftuar; RVV fq. 18]** Kontratat e punës përcaktojnë detyrat dhe përgjegjësitë për rolet, kohëzgjatjen e punësimit, pushimet e paguara, orët në javë dhe kushtet e tjera të punësimit. UBT-ja, përmes analizës SWOT, ka identifikuar se duhet të bëhen më shumë përpjekje për të hartuar përshkrime të qarta të vendeve të punës për secilin funksion, përfshirë edhe stafin joakademik. **[Piani Strategjik i UBT-së 2016-2025]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një **dobësi** në mungesën e përshkrimit të vendeve të punës për çdo funksion në Institucion dhe **rekomandon** që Universiteti të vazhdojë të hartojë përshkrime të vendeve të punës për të gjitha rolet, për të mbështetur më tej sigurimin e standardeve. **[Kapitulli III Standardi IV.1 dhe Standardi II.2]**

2.8 Universiteti përcakton dhe menaxhon fondet e alokuara nga buxheti i shtetit në pajtim me rregulloret ligjore. Zhvillimi i buxhetit të Universitetit është ndërmarrë në dy faza. **[114 Punë me dokumentacionin Nr. 10, datë 05.01.2016; Buxheti i vitit 2016 i dërguar nga MAS në UBT]** Kërkesat e buxhetit janë identifikuar në nivelin e departamentit, të miratuara nga dekani dhe të dorëzuara te Rektori. **[115. Dokumentet Nr. 10 / 2; Kërkesa për ndarjen e buxhetit 2016, 113 Punë me dokumentacionin Nr. 10/4]** Zyra e Rektorit është përgjegjëse për zhvillimin e buxhetit të institucionit i cili i dorëzohet Senatit Akademik dhe Këshillit Akademik për miratim. **[138 Vendimi i Këshillit Administrativ Nr. 1; “Për hollësitë e granteve për vitin 2016”; 192 Raporti i Veprimtarisë Financiare]** Përgjegjësitë për menaxhimin financiar janë përcaktuar brenda kompetencës së Senatit të Universitetit. **[118 Statuti i UBT-së; M2 Rektori; Stafi I lartë drejtues M3]** Universiteti gjithashtu ka një Grup Menaxhimi Strategjik me përgjegjësinë për mbikëqyrjen e menaxhimit të buxhetit. **[139 Vendimi i Këshillit Administrativ Nr. 3; 131 Urdhri Nr. 20, datë 20.01.2015, 85 Pyetësori i Vetëvlerësimit për vitin 2015, nr. 81/1]** Buxheti vjetor balancon të ardhurat dhe shpenzimet, dhe mbështet ata që gjenerojnë më shumë të ardhura, pa diskriminuar ata që prodhojnë më pak. **[138 Vendimi i Këshillit Administrativ Nr. 1 “Për hollësitë e granteve për vitin 2016”; Kapitulli III Standardi VI.2]**

2.9 Universiteti dorëzon buxhetin vjetor në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, që përfshin një deklaratë mbi menaxhimin e riskut. **[86 Raport mbi realizimin e buxhetit për ndarjen e vitit 2015 dhe 2016, nr. 10/20]** Si institucion publik, të gjitha veprimtaritë financiare menaxhohen në përputhje me ligjin. **[86 Raport mbi realizimin e buxhetit për ndarjen e vitit 2015 dhe 2016, nr. 10/20; 139 Vendimi i Këshillit të Administrimit Nr. 3 për “Miratimin e strukturës së stafit akademik të UBT-së për vitin 2016”; 192 Raporti i Veprimtarisë Financiare; Kapitulli III Standardi IV.2]** Treguesit financiarë raportohen rregullisht në Këshillin e Administratës, si edhe në fund të periudhës nëntë mujore. **[116 Punë me dokumentacionin nr. 1683 'Realizimi i treguesve financiarë për 9 muajt e parë të vitit 2015; 88 Raporti mbi Projektbuxhetin Afatmesëm 2016 deri 2018 të datës 07/20/2015]** Universiteti i nënshtrohet auditimeve financiare të kryera nga ekspertët auditues

të brendshëm (aktualisht në proces), si dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit. Të gjitha raportet shqyrtohen nga Rektori dhe Këshilli Akademik. **[64 Plani vjetor dhe strategjik i miratuar nga Rektori nr. 1587 / 1]** Raporti i veprimtarisë financiare diskutohet gjerësisht në Universitet dhe i prezantohet të gjithë stafit dhe studentëve. **[Stafi i lartë drejtues M3; Studentët M4 & M8; Kapitulli III Standardi VI.3]**

2.10 Universiteti është angazhuar me kompjuterizimin. Ai ka bashkëpunuar me Agjencinë Kombëtare të Provimeve (AKM), duke regjistruar studentët nga AKM në sistemin e Zyrës për Studentët dhe Studimet (ZSS), dhe vazhdon përdorimin e Numrit të Matrikullave. **[117 State (matura.akf.gov.al - udhëzime teknike AKP) (Udhëzimi MAS 27, Kapitulli III Standardi VII.2)]** Një sistem i integruar informacioni i bazuar në projektin RASH, ofron menaxhimin e sistemeve, një strategji gjithëpërfshirëse e sigurisë së informacionit, **[15 ESSE3 (Sistemi Operativ i zyrës universitare të mësimdhënies), IRIS (Sistemi i menaxhimit të kërkimit)]** Zhvillimi dhe zbatimi i sistemeve të integruara të informacionit ndihmojnë që Universiteti të funksionojë si një komunitet, mbështesin përdorimin efektiv të burimeve, gjë që përbën **praktikë të mirë**. Faqja zyrtare ofron informacion për fakultetet, ciklet dhe programet e studimit, strategjinë e sigurisë së informacionit dhe një sërë dokumentesh administrative, përfshirë Statutin, rregulloret dhe të dhënat institucionale. **[159 Faqja e internetit e UBT-së: <http://ubt.edu.al/>; M4 studentët universitarë; M10 IT demonstrim]** Zhvillimi i vazhdueshëm i faqes online të Universitetit dhe i sistemeve online mbështet përcjelljen e mesazheve kryesore, informacionit për programet dhe të dhënat për studentët dhe stafin. **[Kapitulli III Standardi VII.1 dhe Standardi V.2]**

2.11 Universiteti zotëron kampusin e vet dhe ndërtesa, që ndodhen jashtë Tiranës. Ndërtesat e Universitetit u ndërtuan midis viteve 1957 dhe 2010, dhe kanë pësuar rinovim dhe zhvillim të konsiderueshëm. **[3 Akti i komisionimit për përforcimin të tokës së ndërtesës së vjetër të FEA-së; 48 Lista e objekteve të UBT-së për mësimdhënien]** Pesë fakultetet e tij ofrojnë një sërë ambientesh, duke përfshirë sallat kulturore leksionesh, laboratorët didaktikë dhe laboratorët e kërkimit shkencor. **[RVV fq.24; Vizita në terren]** Të gjitha ndërtesat ofrojnë izolim të mjaftueshëm, me shumicën e ndërtesave me dritare të dyfishta, ngrohje qendrore, dhe në disa zona me ajër të kondicionuar. **[22 Situata e pronave dhe e objekteve të UBT-së, M7 Stafi akademik dhe pedagogët përgjegjës, M4 studentët e diplomuar; Anketimi i Studentëve; Kapitulli III Standardi VII.3]** Kërkesat hapësinore dhe objektet plotësojnë standardet shtetërore (minimumi 3.8 m², maksimumi 8.0 m²), kanë dritë të mjaftueshme dhe lartësi maksimale prej jo më pak se 3.0 m në ambientet e mësimdhënies. **[70 Planet e ndërtesave; 81 Raportet e sigurimit të cilësisë së brendshme të fakulteteve të UBT-së për vitin 2014; Tabela përmbledhëse e hapësirave 2016; M7 Stafi akademik dhe pedagogët përgjegjës, studentët universitarë M4]** Të gjitha objektet janë të pajisura me sisteme të pajisjeve kundër zjarrit, përveç ndërtesës B e cila është e pajisur me një central qendror të mbrojtjes nga zjarri. **[70 Planet e Ndërtimit]** I gjithë stafi i lartë drejtues dhe profesorët kanë një zyrë individuale dhe ofrohen zyra të përbashkëta për lektorët dhe stafin administrativ. **[81 Raportet e sigurimit të cilësisë së brendshme të fakulteteve të UBT-së për vitin 2014; Vizita në terren]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konfirmoi se vlera e përmirësimit të vazhdueshëm të objekteve, duke përfshirë ato që lidhen me kushtet higjienike, do të sigurojë një mjedis të sigurt për ofrimin dhe menaxhimin e mësimdhënies dhe kërkimit. **[M4 studentë; M8 Studentët pasuniversitarë; Anketimi i stafit; Anketimi i Studentëve; Kapitulli III Standardi V.1]**

2.12 Universiteti mban një regjistër të plotë të pasurive të veta të patundshme, të cilat janë paraqitur në pasqyrat vjetore financiare, që janë pjesë e bazës së aseteve të prekshme. **[37 Kopjet e certifikatave të Pasurive të UBT-së; 65 Kampuset dhe planet e ndërtesave të UBT-së; Tabela përmbledhëse e objekteve universitare]** Universiteti menaxhon në

mënyrë efektive asetet e tij, duke përfshirë mbikëqyrjen e projekteve të ndërtimit që ndjekin një proces standard të prokurimit. **[2 Akti i komisionimit për objektin: “Ndërtimi i objekteve sanitare të jashtme të FEA-së”;** 87 Raporti përfundimtar i punimeve, nëntor 2015, për objektin “Ndërtimi i tualeteve jashtë FEA-së”; 67 Aktet e komisionimit; 89 Rikonstruksioni i Qendrës Eksperimentale të Verës, prill 2013. Akti i komisionimit; Vizita në terren] Është vendosur një politikë për ruajtjen e trashëgimisë së institucionit në aspektin akademik, kulturor dhe shkencor. **[24 Historia e FEA-së, 2014]**

2.13 Shërbimet për palë të treta ofrohen për të përmbushur kërkesat e organizatave publike dhe private, veçanërisht në fushat e analizës së tokës, ushqimit dhe ujit, bazuar në ekspertizën e njohur të fakulteteve dhe studimet e vazhdueshme, duke përfshirë projektet bashkëpunuese. **[28 linqe për fotografimet e ekranit në internet; Lista e projekteve kërkimore; 43 Lista e bizneseve që kanë marrëveshje bashkëpunimi]** Shërbime të tilla të specializuara mbështesin transferimin e njohurive dhe zhvillimin e menaxhimit të zgjeruar të sistemeve dhe përbëjnë **praktika të mira**. **[51 Lista e projekteve; 43 Lista e bizneseve që kanë marrëveshje bashkëpunimi; Punëdhënësit M5; M3 Staf i lartë drejtues]** Puna aktualisht zhvillohet vetëm me agjencitë kryesore dhe bizneset më të mëdha. Universiteti mund të realizojë një anketim, për të mundësuar vlerësimin e shërbimeve më të gjera, që ofrohen për të mbështetur nevojat e tregut vendor dhe rajonal. **[Kapitulli III Standardi VII.6]**

2.14 Zyra për Studentët dhe Studimet është përgjegjëse për mbajtjen e një arkivi qendror të bazuar në dokumentacion dhe rekordet e regjistrimeve dhe matricullimit të studentëve. **[91 Rregullorja e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore; 92 Rregullore e Zyrës së Studentëve dhe Studimeve]** Universiteti ka zhvilluar së fundmi sisteme elektronike për grumbullimin e të dhënave dhe ruajtjen e dokumenteve në formë elektronike. **[84. Regjistrat elektronikë në ZSS; 94 Rregullore e DIOKS; Rregullorja e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore]** Sistemi i regjistrimit të studentëve përfshin informacion mbi regjistrimin e studentëve, programet e studimit, planet mësimore dhe kreditë. **[84 Regjistrat elektronikë në ZSS; 198 faqe e internetit të M6a dhe demonstrim i sistemit online]** Të dhënat themelore mbahen në format dokumenti të printuar dhe në formë elektronike në ruajtje të përhershme, duke përfshirë notat dhe diplomat. **[RVV fq. 30; faqe e internetit të M6a dhe demonstrim i sistemit online; Kapitulli III Standardi V.2]**

2.15 Përgjegjësitë për burimet përcaktohen qartë në Statutin e Universitetit dhe rregulloret e brendshme dhe përmbushin standardet e cilësisë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka identifikuar praktikën e mira në angazhimin me projektet e jashtme, zhvillimin e sistemeve të integruara të informacionit, për të rritur komunikimin dhe punën e transferimit të njohurive, veçanërisht në fushat e tokës, prodhimit të ushqimit dhe cilësisë së ujit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që Universiteti të vazhdojë me përshtime të zhvilluara për të gjitha funksionet dhe pozicionet për të mbështetur më tej sigurimin e standardeve nga institucioni.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Angazhimi i Universitetit në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë shkëmbimet e stafit, që mbështesin mobilitetin e stafit dhe zhvillimin e ekspertizës (pika 2.3)

- Zhvillimi dhe zbatimi i sistemeve të integruara të informacionit që ndihmojnë Universitetin të funksionojë si një komunitet dhe të mbështesë përdorimin efektiv të burimeve (pika 2.10)
- Shërbimet e specializuara mbështesin transferimin e njohurive dhe zhvillimin e menaxhimit të zgjeruar të sistemeve (pika 2.13).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Mungesa e përshkrimeve të punës për çdo funksion në Universitet (pika 2.7).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Universiteti të vazhdojë me zhvillimin e përshkrimeve të punës për të gjitha funksionet (pika 2.7).

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi ndonjë veprim që po ndërmerret në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht.

Fusha e vlerësimit 3: Kurrikula

3.1 Universiteti ofron programe studimi në përputhje me misionin e vet, i cili përqendrohet në edukimin profesional në bujqësi, ekonomi bujqësore, ushqim dhe mjedis. Informacion rreth ofertës akademike sigurohet nëpërmjet faqes së internetit **[159 Website - www.ubt.edu.al]** dhe përmes një udhëzuesi informativ **[23 Udhëzuesi i UBT-së 2012]** Është kryer studimi i tregut për të mbështetur zhvillimin e programeve të reja akademike, të përputhura me kërkesat kombëtare të tregut të punës. **[M4 & M8 Studentët & M9 Stafi Administrativ; Kapitulli I Standardet I.1; ESG 1.8 Informacione Publike]**

3.2 Universiteti mban kontakte me institucionet e arsimit të mesëm përmes panairove shkollore dhe ditëve të hapura të cilat mbështeten nga të diplomuarit. **[19 foto nga panairi - qershor 2016]** Ditët e hapura u ofrojnë studentëve të ardhshëm një panoramë të programeve studimore dhe lehtësirat që Universiteti mund të ofrojë. **[100 Rregulloret e Studimeve Universitare, neni 23]** Numri i pranimit të studentëve administrohet në mënyrë të centralizuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe varet nga rezultatet akademike të secilit student nga shkolla e mesme. Universiteti i përcjell Ministrisë numrin e studentëve që dëshiron të pranojë; megjithatë, vendimi përfundimtar i takon Ministrisë. **[M9 Shtabi Administrativ; Kapitulli I Standardi I.1; Pranimi i studentëve 1.4 të ESG]**

3.3 Studimet akademike në Universitet mund të ndiqen nga shtetas shqiptarë, shqiptarë etnikë dhe joshqiptarë, bazuar në kriteret e MAS dhe kuotat e miratuara nga Këshilli i Ministrave **[100 - Rregullorja e Studimeve Universitare nenet 72,73,74 & 75; 131 Rregullorja e Studimeve Universitare, neni 10]** Në vitin 2015-16, Universiteti kishte një popullsi totale studentore prej 14,373, prej tyre 10,234 me kohë të plotë dhe 4,139 studentë me kohë të pjeshme. **[188 Numri i studentëve në fakultete; Kapitulli I Standardi I.2]**

3.4 Programet e studimeve ofrohen si brenda kampusit të Universitetit, ashtu edhe jashtë tij, me qëllim që studentët të zhvillojnë për një periudhë të caktuar praktika të strukturuar profesionale të cilat janë pjesë përbërëse e kurrikulës së çdo programi studimor. **[100 Rregullorja e Studimeve Universitare, nenet 32,33,34,35,38,39,40 & 83]** Universiteti siguron që të gjitha programet e ciklit të parë të përfshijnë një periudhë të detyrueshme praktike profesionale ose stazhi, për të mundësuar zhvillimin e aftësive praktike. Universiteti ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me një sërë ndërmarrjesh për të mbështetur këtë aktivitet. **[43 Lista e bizneseve me marrëveshjet e bashkëpunimit; 100 Rregulloret e Studimeve Universitare neni 38/39/40]** Të gjitha periudhat në praktikë vlerësohen formalisht dhe marrin kredite evropiane, rregullimi i të cilave funksionon në nivel fakulteti. **[Dokumenti 98 Rregullorja e Brendshme e Fakultetit të UBT-së; 100 Rregullorja e Studimeve Universitare neni 61]** Programi i praktikës profesionale për studentët e Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit jep një shembull të dobishëm të udhëzimeve në dispozicion të studentëve. Udhëzimet për Programin e Praktikës Profesionale u ofrojnë studentëve informacion për të mbështetur përvojën e tyre të punës dhe aftësitë praktike dhe është një **praktikë e mirë. [66 Procedurat për zhvillimin e praktikës profesionale]** Në diskutim me studentët e ciklit të parë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konfirmoi që Programi i Praktikës profesionale ishte i dobishëm në përgatitjen për punësim dhe zhvillimin e aftësive praktike. **[M4 & 8 Studentët; M5 Punëdhënësit]** Programet vlerësohen dhe testohen përmes vlerësimit të vazhdueshëm, provimeve përfundimtare të moduleve dhe provimeve të praktikës profesionale **[66 Procedurat për Praktikën Profesionale]** duke përfshirë mikrotezën dhe provimin e shtetit. **[68 Regjistri i mbrojtjes së mikrotezës dhe provimeve të shtetit; Kapitulli I Standardi I.3 dhe Standardi I.4]**

3.5 Universiteti synon të ofrojë programe studimi që përgatisin studentët për punësim. Modulet janë të një natyre profesionale dhe përfshijnë njohuri të fushave ekonomike dhe sociale. **[69 Programi i studimit në Ekonomi dhe Agrobiznes]** Programet përfshijnë njohuri mbi sipërmarrjen, praktikën dhe projektet e shkëmbimit të realizuara në bashkëpunim me bizneset vendore. Programet e studimeve në mjekësi veterinarë, bujqësi, pylltari dhe bioteknologji ofrojnë praktika profesionale të punës laboratorike, që plotësojnë nevojat praktike të trajnimit të studentëve. **[M4, & M8 Studentët; Punëdhënësit M5; M, 7 Stafi akademik]** Studentët shpesh marrin pjesë në aktivitete kulturore dhe edukative, si p.sh. pjesëmarrja në “panaire” **[Dita e lumtur - RVV fq. 35]** ose në një maratonë. **[Dita Botërore e veshkave - RVV fq. 35; Kapitulli I Standardi 1.5]**

3.6 Programet me kohë të pjesshme tani janë të mbyllura për pranimet e reja dhe po iu ofrohet mësim si studentë të vitit të tretë të ciklit të parë. **[100 – Rregullore e Studimeve e UBT-së, neni 41]** Universiteti konfirmoi miratimin e një vendim të Qeverisë që ndalon rekrutimin e studentëve të ciklit të parë me kohë të pjesshme në programet e studimit, dhe drejtuesit e lartë konfirmuan se për studentët që po vijojnë studimet, programet po zhvillohen sipas planit **[Stafi i lartë drejtues M3]** Vendimi i qeverisë ka pasur një ndikim financiar në Universitet dhe për ta trajtuar, Universiteti po ofron programe të tjera për të mbuluar hendekun financiar. **[M 3 Stafi i lartë drejtues; Stafi Akademik M7; Kapitulli I Standardi I.2]**

3.7 Strategjia e Universitetit është e veçantë, pasi është në përputhje me strategjinë kombëtare bujqësore, që është një sektor i rëndësishëm i ekonomisë kombëtare të Shqipërisë. **[119 Strategjia 2005-2012 e UBT-së]** Strategjia e Universitetit 2005-2012 rregullon ofertën akademike të secilit fakultet dhe secili fakultet ofron programe studimi në të gjitha ciklet, Bachelor, Master dhe Doktoratë. Struktura e programeve është në përputhje me Procesin e Bolonjës, **[119 Strategjia e UBT-së, pika 4.5.1]** dhe përshkruan kompetencat profesionale që duhet të fitohen nga studentët, me në qendër “të mësuarit duke vepruar”. **[119 Strategjia e UBT-së, pika 4 dhe 4.4.1]** Pas përfundimit, studentët marrin një diplomë dhe suplement diplome. **[M 2 Rektori; Stafi i lartë drejtues M3; Punëdhënësit M5; Kapitulli I Standardi I.3]**

3.8 Në lidhje me programin e studimeve ndërdisiplinore të Universitetit, Diploma e Përbashkët Ndërkombëtare në Mjekësinë e Bimëve realizohet me 11 institucione të arsimit të lartë në Evropë. Programi synon të ndërtojë kapacitete kërkimore, njohuri dhe aplikime praktike. Masteri i Përbashkët Ndërkombëtar në Mjekësinë e Bimëve pasqyron vlerën e kërkimit ndërdisiplinor që Universiteti ndërmerr me institucionet e tjera evropiane, për të krijuar fondin e njohurive dhe praktikës, gjë që përbën **praktikë të mirë**. **[58 Modeli i Masterit të Shkencave në Mjekësinë Bimore dhe Dëshmi 12]** Studentët që përfundojnë studimet në Master Profesional dhe i Shkencave, gjithashtu japin një provim të detyrueshëm të gjuhës së huaj. **[153 Vendimi i Senatit qershor 2016; M2 Rektori; Stafi i lartë drejtues M3; Kapitulli I Standard I.9]**

3.9 Universiteti aplikon një model planifikimi të ngarkesës së punës për stafin akademik, dhe udhëzimet përcaktohen dhe planifikohen nga njësi bazë e MES-it. **[RVV fq. 30]** Të gjitha planifikimet kryhen para fillimit të vitit akademik. Ngarkesa e punës llogaritet në bazë të tre komponentëve: Mësimdhënia (auditori dhe përgatitja e mësimdhënies - 750-1,050 orë), aktivitetet që lidhen me kërkimin, zhvillimin dhe transferimin e teknologjisë (300 orë) dhe aktivitetet mbështetëse (150-300 orë). **[106 Shembulli i miratimit të planit të mësimdhënies; Stafi akademik M7]** Stafi akademik lejohet të tejkalojë kohën e kontaktit vjetor të mësimdhënies deri në 30 për qind, pasi ka përfunduar detyrimet e veta me orar të plotë; pagesa bëhet nga Universiteti si të ardhura dytësore. **[149 Vendimi i Senatit të UBT-**

së për pagesat jashtë orarit] Në diskutim me stafin akademik, ata konfirmuan se ata që tejkalojnë normën e tyre vjetore të mësimdhënies nuk përpiqen të jenë aq aktivë në kërkim, dhe në këtë mënyrë kanë mundësi për të ndërmarrë ngarkesë shtesë mësimore. Stafi ka konfirmuar se cilësia e mësimdhënies po ruhet edhe në këto fusha të mësimdhënies shtesë. **[Stafi akademik M7; 183 Ngarkesa e punës së stafit akademik]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm do ta këshillonte Universitetin që të mbajë nën vëzhgim kohën vjetore të mësimdhënies, në periudhën që po vlerësohet, për të shmangur ndikimin në performancën e pedagogëve dhe për të zhvilluar mësimdhënie me cilësi të lartë. **[Kapitulli I Standardi I.5]**

3.10 Programet e studimit dhe objektivat e tyre janë të përcaktuara qartë dhe mund të gjenden në faqen e internetit të Universitetit, që u tregon studentëve përmbajtjen e programeve të tyre, duke përfshirë programet e detajuara. **[30 Faqja online]** Modulet janë të përgatitura në gjuhën shqipe dhe angleze, dhe miratohen dhe depozitohen në çdo departament. **[121 Programi lëndor i plotë për secilin fakultet 2015-2016]** Nga vlerësimi i materialeve të ofruara nga Universiteti, programet e moduleve janë të detajuara dhe përfshijnë njohuri dhe aplikime praktike. **[121 Programi i plotë lëndor për secilin fakultet 2015-16; 82 Programi lëndor i një moduli me praktikë profesionale, Kontrolli i erozionit]** Cilësia dhe detajet e programeve të moduleve, siç ilustron nga kursi Biokimi dhe Menaxhimi i Erozionit dhe i Kufirit Ujor, tregojnë që programet e studimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe se objektivat janë të përcaktuara qartë. Çdo program i ofruar nga Universiteti është i licencuar nga Këshilli i Ministrave ose nga Urdhrat e Ministrit të Arsimit. **[75 Propozimet për kuotat dhe tarifatat 2015-16; Studentët M4; Kapitulli I Standardi I.6; ESG 1.2 Hartimi dhe miratimi i programeve]**

3.11 Programet e studimeve në Universitet për ciklin e parë iu ofrojnë studentëve njohuri për lëndët, metodat dhe parimet shkencore për fushën përkatëse të studimit. Vihet re një përqendrim te aftësitë e veçanta, duke përfshirë edhe gjuhët e huaja, njohuritë kompjuterike dhe aftësitë e punës në grup. **[38 Kurrikula e programeve të studimit]** Programet e ciklit të parë janë të konceptuara për të mbështetur punësimin e ardhshëm. Kontekstet e punësimit janë reflektuar në kurrikulat e secilit program dhe në udhëzimet e studimeve të fakulteteve. **[69 Programi i studimit në Ekonomi dhe Agrobiznes - Menaxhimi i Turizmit Rural]** Zyra e Studimeve dhe Studentëve ofron informacion mbi transferimin e programeve dhe krediteve dhe Zyrat e Karrierës dhe Studentëve në çdo departament ofrojnë mbështetje vendore. **[92 Rregullore e OSS; Kapitulli I Standardi I.7]**

3.12 Zyra e Studentëve dhe Karrierës lehtëson njohjen e çdo studenti me mjedisin e Universitetit, dhe gjithashtu monitoron performancën e studentëve, për shembull nëpërmjet raporteve të analizës të mesatares së notave. **[148 Vendimi i Senatit për qendrat e karrierës së UBT-së dhe fakulteteve; 92 Rregullore e ZSS; M10 Demonstrim i IT]** I gjithë stafi me kohë të plotë është i angazhuar për zbatimin e programeve në ciklin e parë. Stafi akademik përdor një shumëllojshmëri metodash alternative të mësimdhënies në përgjigje të interesave të studentëve. **[82 Ref. për programin lëndor & 81 Raport Vetëvlerësimi i Fakultetit]** Raportet e vetëvlerësimit të fakultetit japin një vlerësim të hollësishëm të pikave të forta dhe të dobëta të ofertës akademike të fakulteteve. Plotësia e raporteve të vetëvlerësimit të fakultetit të cilat mbështesin vlerësimin dhe zhvillimin e kurrikulës paraqesin karakteristika të **praktikës së mirë** dhe tregojnë rëndësinë që fakultetet i kushtojnë ofrimit të shërbimeve. Megjithatë, raportet dhe rezultatet mund të përmirësohen, duke zhvilluar një plan të qartë veprimi, që monitorohet dhe vlerësohet rregullisht. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konsideron se zhvillimi i planeve të veprimit që lidhin departamentin dhe fakultetin me raportet e analizës së mësimdhënies mund të rrisin procesin e vlerësimit dhe zhvillimin e ardhshëm. **[81 Raport Vetëvlerësimi i fakultetit; Stafi Akademik M7; M9 Stafi Administrativ; Kapitulli I Standardi I.8]**

3.13 Universiteti administron një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me sektorin privat dhe me kompani shtetërore, për shembull ndërmjet Fakultetit të Mjekësisë Veterinare dhe Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Institutit Veterinar, si edhe ndërmjet Universitetit dhe Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Menaxhimit të Ujit. **[53 & 54 - Marrëveshjet e Bashkëpunimit]** Universiteti zhvillon aktivitete kërkimore, nëpërmjet profesorëve me kohë të plotë dhe lektorëve të ftuar nga institucionet jashtë vendit. Shumica e stafit janë me kohë të plotë siç tregohet në Analizën e Procesit Mësimor 2014-2015. **[7 Raporti i Analizës së Procesit Mësimor]** Programet e Masterit të Shkencave janë hartuar në përputhje me politikën e kërkimit shkencor të Universiteteve, **[100 Rregullorja - neni 32/90; 98 Rregullorja e Brendshme e Fakulteteve të UBT-së]** dhe më shumë se 70 për qind e stafit akademik në programet e ciklit të dytë janë staf me kohë të plotë. **[7 Raporti i Analizës së Procesit Mësimor; Stafi i lartë drejtues M3; Stafi Akademik M7; M8 studentët pasuniversitarë; Kapitulli I Standardi I.9]**

3.14 Qendra e Karrierës së Alumni synon të mbledhë informacione rreth punësimit të të diplomuarve të Universitetit. **[E 93 - Rregullore e CAO; M9 Stafi Mbështetës]** Megjithatë, aktualisht Universiteti është në një fazë të hershme të zhvillimit lidhur me mbledhjen e njëtrajtshme të të dhënave të punësueshmërisë, që planifikon të përdorë në funksion të përmirësimit të ofertës akademike. **[M10 Demonstrim i IT; Stafi Mbështetës i M9]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi grumbullimin e paqëndrueshëm dhe analizën e të dhënave të punësueshmërisë, për të informuar zhvillimin e kurrikulave dhe përgatitjen për punësim, si një sferë për zgjerim dhe zhvillim. Universiteti e ka të qartë se kërkohet më shumë punë për analizën e të dhënave të punësueshmërisë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon se Universiteti po punon për të vazhduar analizën e të dhënave dhe informacioneve të punësimit të të diplomuarve, në mënyrë që të garantojë se programet e studimit t'iu përputhen nevojave të ardhshme të punësueshmërisë **[M7 Stafi Akademik; Kapitulli I Standardi I.12]**

3.15 Me qëllim rritjen e mobilitetit të studentëve, të gjitha programet studimore në Universitet (cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë) organizohen në përputhje me procesin e Bolonjës. Çdo program vlerësohet në kredite evropiane sipas sistemit ECTS **[100 Rregullorja e studimeve, përkufizimet, neni 19]** Të gjitha diplomat pas përfundimit marrin një Supplement Diplome, e cila mundëson mobilitetin e studentëve nëpërmjet programit Tempus. **[Dëshmi 100 Rregulloret 68 & Rregulloret 60]** Universiteti nxit të mësuarit e gjuhëve të huaja në mënyrë që të përmbushë politikën e vet për ndërkombëtarizimin. Studentët në ciklin e dytë dhe të tretë kryejnë një provim të gjuhës angleze, siç kërkohet nga ligji i arsimit të lartë; **[Nr. 80/2015; 153 - Vendimi i Senatit]** mësimdhënia në të gjitha programet e studimit zhvillohet në gjuhën shqipe. Universiteti nuk ka ndërtuar një proces për vlerësimin dhe transferimin e krediteve të fituara në institucionet e huaja të arsimit të lartë, dhe aktualisht kreditet transferohen pa u vlerësuar. **[100 Rregullorja e nenit 60/72/73/74; Kapitulli I Standardi 1.10; Kapitulli I Standardi I.11]**

3.16 Misioni i Universitetit është i përqendruar në një kurrikulë, që i shërben kërkesave kombëtare, për të nxjerr të diplomuar të orientuar në arsimin profesional në bujqësi, ekonomi bujqësore, ushqim dhe mjedis. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi praktika të mira në përgatitjen e studentëve për praktikën profesionale, punën e përbashkët akademike në nivelin Master me institucionet evropiane dhe në tërësinë e raporteve të vetëvlerësimit të fakultetit që mbështesin vetëreflektimin dhe përmirësimin e kurrikulës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon se Universiteti zhvillon një qasje të qëndrueshme në analizën e të dhënave të punësueshmërisë, për të ndihmuar zhvillimin e ardhshëm të kurrikulës dhe përgatitjen e studentëve për punësim.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Udhëzimet për Programin e Praktikës Profesionale u ofrojnë studentëve informacion për të mbështetur përvojën e tyre të punës dhe zhvillimin e aftësive praktike (pika 3.4)
- Masteri i Përbashkët Ndërkombëtar i Mjekësisë së Bimëve tregon vlerën e kërkimit ndërdisiplinor që Universiteti ndërmerr me institucionet evropiane, për të krijuar fondin e njohurive dhe praktikës (pika 3.8)
- Përmbledhja e raporteve të vetëvlerësimit të Fakultetit që mbështesin vlerësimin e kurrikulës dhe zhvillimin (pika 3.12).

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk ka bërë asnjë rekomandim në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Pohim i veprimit të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon se veprimet e mëposhtme po ndërmerren aktualisht:

- Përparimi i analizës së të dhënave të punësimit të të diplomuarve dhe informacionit, për t'u siguruar që programet e studimit t'iu përputhen nevojave të ardhshme të punësueshmërisë (pika 3.14).

Gjykim

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

4.1 Universiteti ka procedura të qarta për menaxhimin e ofertës së tij akademike, përfshirë dhe kërkimin shkencor. Fakultetet e Universitetit përdorin një sistem të planeve mësimore dhe programeve të moduleve, për të mbështetur koordinimin sistematik të mësimdhënies dhe ngarkesën e stafit. **[135 Rregullorja e Studimeve Universitare, neni 92 (d) dhe (e); RVV, fq.30-31]** Planet mësimore dhe programet e modulit ndjekin një model standard, që mbulon kreditet ECTS, objektivat e të nxënit, kohëzgjatjen, orët e mësimdhënies dhe vlerësimin. **[18 Format i Detajuar i një Plani Mësimor] 135 Rregullore e Studimeve Universitare, Shtojca 2; 158 Faqja e internetit e lektorëve]** Koherenca rrjedh edhe nga vlerësimi vjetor i mësimdhënies i kryer nga departamentet në të gjithë Universitetin. **[7 Raporti i Analizës së Procesit Mësimor]** Kjo çon në përditësimin e planeve mësimore dhe programeve të moduleve në fillim të çdo viti akademik pas një procesi miratimi. **[16 Format i Detajuar i një Plani Mësimor, fq.1; 158 Rregullore e Studimeve Universitare, fq.1; RVV, fq.36; M2 Rektori; Stafi i lartë drejtues M3; M9 Pranimet dhe Stafi Mbështetës]** Politika e Universitetit përcakton numrin maksimal të studentëve për leksion (80), seminare (40) dhe aktivitete laboratorike (15), për të siguruar që burimet fizike të përdoren në mënyrë të efektshme. **[135 Rregullorja e Studimeve Universitare, Neni 33]** Vlerësimi i mësimdhënies për vitin 2014-2015 nxjerr në pah disa çështje, për shembull, investime të pakta në burimet laboratorike të mësimdhënies për shkak të mungesës së buxhetit, **[Raporti i Analizës së Procesit Mësimor fq.15-17]** dhe se nevojiten më shumë teknika. **[RVV fq.35]** Për më tepër, megjithëse Anketimi i Studentëve i kryer nga APAAL-i kishte një shkallë të ulët të përgjigjes (8 për qind e atyre që morën një pyetësor, që përfaqësojnë 3 për qind të popullsisë totale studentore), ai tregoi se mbi 25 për qind e të anketuarve besonin cilësia e sallave dhe laboratorëve të mësimdhënies ishte e dobët ose shumë e dobët. **[Anketimi i Studentëve, fq.16]** Kjo u konfirmua në takimet me stafin dhe studentët të cilët treguan se burimet, veçanërisht laboratorët mësimorë, mund të përmirësoheshin. **[M4 studentë; Stafi akademik M7]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideroi burimin e laboratorëve të mësimdhënies, që është një pjesë thelbësore e mësimin të bazuar në praktikë, si një **dobësi**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që Universiteti të përmirësojë cilësinë e laboratorëve të mësimdhënies **[Kapitulli I Standardi II.1]**

4.2 Universiteti përdor protokolle efektive për lidhjen e praktikave mësimore me kërkesat e vlerësimit, **[135 Rregullorja e Studimeve Universitare, nenet 38-40; RVV, fq.36]** të cilat mbikëqyren nga komisionet e praktikës mësimore në nivel fakulteti. **[132 Rregullore e një Fakulteti të UBT-së (FEA), neni 92; 95 Procedurat për Zhvillimin e Praktikës Profesionale, fq.5]** Punëdhënësit që ofrojnë praktika lidhin marrëveshje me Universitetin. **[95 Procedurat për Zhvillimin e Praktikës Profesionale, fq.7; M5 Punëdhënësit dhe partnerët e jashtëm; E51, Lista e Marrëveshjeve]** Stafi dhe studentët konfirmuan se mundësitë e praktikës profesionale janë kryesisht të disponueshme për studentët. **[M4 studentë; Stafi Akademik M7; M8 Studentët pasuniversitarë]** Universiteti përcakton qartë se si diplomat e programeve Master dhe doktoratës vlerësohen nga teza. **[135 Rregullorja e Studimeve Universitare, nenet 61 dhe 64; 116 Programi i Përbashkët i Doktoraturës në Ndërmarrësi, Nenet 22-26; Kapitulli I Standardi II.1]**

4.3 Stafi akademik ka përgjegjësinë për të siguruar që studentët të kenë akses në literaturën e duhur. **[100, Rregullore e programeve të studimit, Neni 92 (h)]** Burimet e të mësuarit janë të disponueshme nga Biblioteka Universitare (duke përfshirë librat dhe revistat elektronike), bibliotekat e fakultetit dhe mjedisi virtual i mësimin. **[Vizita në terren; M10]**

demonstrim i IT] Studentët dhe stafi vlerësojnë se këto i plotësojnë kërkesat për studim dhe kërkime. **[M4 Studentët e nivelit Bachelor; M8 Studentët pasuniversitarë; Kapitulli I Standardi II.1]**

4.4 Universiteti ka rregullore të qarta për vlerësimin të cilat publikohen në faqen e internetit të Universitetit dhe janë të aksesueshme na studentët. **[135 Rregullorja e Studimeve, nenet 44-60; RVV fq.37; M4 Studentët e nivelit Bachelor; M7 Studentët pasuniversitarë]** Provimet vlerësohen nga pedagogët në format anonim dhe rezultatet publikohen në mënyrë konfidenciale, nëpërmjet portalit, ku studentët hyjnë përmes një fjalëkalimi personal. **[M10 Demonstrim IT; Anketimi Studentor]** Studentëve u sigurohet feedback, dhe, pas publikimit të notave, marrin feedback në fund të semestrit. **[M4 studentë; M10 Demonstrim IT]** Studentët e njohin procedurën e ankesave. **[135 Rregullorja e Studimeve, Neni 52; M4 Studentët e diplomuar]** Çdo ndryshim në nota duhet të njoftohet formalisht te Përgjegjësi përkatës i Departamentit, duke siguruar në këtë mënyrë transparencën. **[135, Rregullorja e Studimeve, Neni 55 (e)]** Pavarësisht shkallës së ulët të përgjigjes, Anketimi i Studentëve kryer nga APAAL-i përcjell një pasqyrë më pak pozitive të vlerësimit me rreth 25 për qind të studentëve të pakënaqur me shkallën e transparencës në vlerësim **[Q5.iv] [Q5.vi]** Përveç kësaj, pothuajse 30 për qind kanë shënuar se notat e tyre janë shpallur pa paralajmërim paraprak **[Q9.iv]** dhe rreth 37 për qind besonin se në provime kopjohet. **[Q9.iii]** Këta faktorë nuk janë të theksuar nga anketimet e brendshme që nuk mbulojnë në mënyrë të qartë vlerësimin. **[108 Raporti i Analizës së Rezultateve të Anketimit të Studentëve]** Këto çështje tregojnë një **dobësi** në zbatimin e vlerësimit, edhe pse nuk u vërtetuan nga studentët në mbledhjet e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që Universiteti të hetojë çështjet e vlerësimit të ngritura nga Anketimi i Studentëve, për të siguruar më tej proceset e vlerësimit. **[Kapitulli I Standardi II.2; ESG 1.4, Pranimi Studentor, Ecuria, Njohja dhe Certifikimi]**

4.5 Departamentet dhe fakultetet angazhohen në monitorimin e hollësishëm vjetor për të përmirësuar cilësinë e mësimin dhe të mësimdhënies. **[110-114 Raportet e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë]** Vlerësimi i mësimdhënies bazohet në Vetëvlerësimin dhe feedback-un e studentëve në fund të semestrit. **[173 Vlerësimi Profesional i UBT-së; 8 Raporti i Analizës së Procesit Mësimor 2014-15; Stafi Akademik M7; 9 Pyetësori për Vlerësimin e Procesit Mësimor nga Studentët; 109 Pyetësorët e Analizës së Rezultateve të Anketimit të Studentëve]** Departamentet dhe fakultetet ndjekin gjithashtu ecurinë dhe përfundimin e studimeve nga studentët, angazhimin e punëdhënësve dhe mundësitë e praktikës. **[7 Raporti i Analizës së Procesit Mësimor 2014-2015]** Siç është përshkruar në pikën 3.14 më sipër, grumbullimi i të dhënave për punësim është në një fazë të hershme dhe ende nuk është i mjaftueshëm për të informuar zhvillimin e kurrikulës, edhe pse disa departamente kanë marrëdhënie të konsoliduara me punëdhënësit që kontribuojnë aktivisht në zhvillimin e kurrikulave. **[M5 Punëdhënësit dhe partnerët e jashtëm; Kapitulli 1 Standardi II.3]**

4.6 Stafi akademik konfirmoi se në dispozicion të tyre janë një sërë mundësish zhvillimore, përfshirë arritjen e shkallëve më të larta të kualifikimit; programi i shkëmbimit Erasmus; ndarja e praktikave më të mira në leksione të hapura, dhe pjesëmarrja në projekte inovatore pedagogjike me partnerët evropianë. **[M 7 Stafi Akademik]** Raporti vjetor i analizës së procesit mësimor dëshmon një angazhim të qartë për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe kurrikulës. Raporti përfshin përmirësime të bëra tashmë në praktikën dhe infrastrukturën e mësimdhënies, identifikon aspektet e përmirësimit dhe përfshin një plan veprimi të nënshkruar nga Senati. **[8 Raporti i Analizës së Procesit Mësimor 2014-15, fq.26-28] [E8, Raporti i Analizës së Procesit Mësimor 2014-15, fq. 15-17; 8 Raporti i Analizës së Procesit Mësimor 2014-15, Plani i Veprimit, pika 9]**

Megjithatë, është e paqartë si dhe ku në strukturën e komisionit, monitorohet dhe vlerësohet zbatimi. Në funksion të rritjes, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm sugjeron që Universiteti të adresojë çështjen e monitorimit të progresit në planet e veprimit. Megjithëse stafi dhe studentët në përgjithësi janë të vetëdijshëm për procesin e monitorimit vjetor dhe studentët pranojnë se feedback-u i tyre nxit përmirësimet, shpërndarja e rezultateve është joformale dhe bazohet në email dhe gojë-më-goje. **[Stafi i lartë drejtues M3; M4, Studentët e Universitetit]**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm sugjeron që Universiteti të shqyrtojë komunikimin e veprimeve kryesore për të rritur shpërndarjen sistematike të informacionit tek stafi dhe studentët. **[Kapitulli I Standardi II.4; ESG 1.3, Të nxënit me në qendër studentët, mësimdhënia dhe vlerësimi]**

4.7 Departamenti është njësi kryesore mësimore dhe kërkimore. Departamentet janë përgjegjëse për zhvillimin dhe menaxhimin e kërkimit dhe organizimin e bashkëpunimeve ndërmjet departamenteve. **[155 Statuti i UBT-së, neni 38]** Aktiviteti kërkimor i universitetit është i përqendruar në fushat e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. **[RVV, fq.40-41; M2 Rektori; Stafi i lartë drejtues M3; 6 Raporti i Analizës së Veprimtarive Kërkimore]** Financimi i kërkimit jepet nga shteti dhe ndahet sipas prioriteteve të miratuara nga Senati. **[155, Statuti i UBT, Neni 61]** Performanca e kërkimit monitorohet dhe vlerësohet çdo vit, duke u përqendruar në grupet kërkimore-arsimore, laboratorët shkencorë, botimet kërkimore dhe programet e doktoraturës. Megjithëse janë identifikuar rekomandime për përmirësim, nuk është e qartë se si monitorohet zbatimi **[6, Raporti i Analizës së Veprimtarive Kërkimore, 2014-15]** Në kuadër të përmirësimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm sugjeron që Universiteti të marrë në konsideratë një proces të qartë dhe transparent, për të monitoruar sferat që janë identifikuar për përmirësim në kërkimin shkencor profesional. **[Kapitulli I Standardi II.5]**

4.8 Fakti që Universiteti ka një angazhim të fortë për kërkimin shkencor është konfirmuar nga numri i projekteve kërkimore të financuara. **[55 Lista e Projekteve Kërkimore, UBT 2015; 56 Lista e projekteve të realizuara në tre vitet e fundit]** Projektet kryesore përfshijnë projektet e sponsorizuara nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit dhe Inovacionit (AKTI) dhe Ministria e Mjedisit, si dhe programet dypalëshe me partnerët evropianë, si FP7 dhe Bashkëpunimi Evropian në Shkencë dhe Teknologji COST). **[55 Lista e Projekteve Kërkimore]** Kërkimi mbështet shumë nga laboratorët kërkimore bashkëkohor të specializuar në analizën e tokës, ujit dhe mbeturinave, si dhe fitosanitimit. **[50 Lista e laboratorëve kërkimor; Vizita në terren; M4 Punëdhënësit dhe Partnerët; RVV, fq.43; Strategjia e kërkimit shkencor E70 e UBT 2016-25, fq.16]** Është një praktikë e mirë kontributi i stafit kërkimor në projekte dhe kërkime që mbështet zhvillimet kombëtare bujqësore dhe ekologjike, në lidhje me interesat ekonomike kombëtare **[Kapitulli I Standardi II.6]**

4.9 Universiteti mbështet ndërkombëtarizimin e kërkimeve të stafit, nëpërmjet Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, e cila merret me ofertat ndërkombëtare kërkimore dhe informacionet rreth konferencave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, **[RVV, fq.45, 49 Lista e konferencave të organizuara nga UBT-ja, fq.2]**. Për shembull Konferenca e Bioteknologjisë në Bujqësi (2014) organizuar së bashku me Universitetin Friedrich Schiller, Jena, Gjermani, me një konferencë të dytë të planifikuar për vitin 2017. **[RVV, fq.45]** Angazhimi i Universitetit në konferenca ndërkombëtare promovon fushat kyçe të kërkimit dhe është një shembull e praktikës së mirë. Që nga viti 2012 ka pasur konferenca/seminare vjetore me pjesëmarrje të stafit dhe studentëve, të organizuara nga Fakultetet e Mjekësisë Veterinare dhe Shkencave Pyjore, për t'iu mundësuar studentëve të angazhohen në kërkime të pavarura shkencore. **[49 Lista e Konferencave të organizuara nga UBT-ja, fq.3]** Studimet shkencore të stafit janë publikuar në revista të vendit dhe në planin ndërkombëtar, në revista të referuara, dhe numri i artikujve që botohen jashtë vendit

është në rritje. [RVV, fq.45-6; E31, Lista e Botimeve të Publikut 2013-2016 Kapitulli I Standardi II.7] Përveç kësaj, Universiteti mbështet stafin për të studiuar në nivelet më të larta të programeve të studimeve në universitetet e huaja. Përfshirja e stafit të Universitetit dhe e studentëve dhe kontributi i tyre në një numër të madh të projekteve dhe publikimeve kombëtare dhe ndërkombëtare përbën **praktikë të mirë**. Universiteti mirëpret lektorët e ftuar dhe mbështet stafin e vet në aktivitete reciproke. Gjithashtu nxit bashkëudhëheqjen e kandidatëve të doktoraturës nga profesorët e institucioneve partnere jashtë vendit, [RVV, fq.49; M8 Studentët pasuniversitarë] duke mbështetur kështu ndërkombëtarizimin e të nxëniet dhe të mësimdhënies. [133, Rregullore e Programeve Studimore të Ciklit të Tretë, Neni 30.6; Kapitulli I Standardi II.10]

4.10 Sferat e kërkimit të qëndrueshëm kanë qenë prioritet për të mbështetur vazhdimësinë e kërkimit, nëpërmjet marrëveshjeve të partneritetit të gjerë të Universitetit me institucionet kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare [RVV, fq.48] Bashkë me mësimdhënien dhe transferimin e njohurive, kërkimi shkencor është një përparësi kryesore e Planit Strategjik kryesor të Universitetit. [E68, Strategjia e Zhvillimit të UBT-së 2016-2025, fq.4] Strategjia e Kërkimit Shkencor të Universitetit ofron një vlerësim të detajuar të kapacitetit të kërkimit dhe sferave potenciale për zhvillim. [70 Strategjia e Kërkimit Shkencor të UBT-së 2016-2025, fq.41-43; 68 Strategjia e Zhvillimit të UBT-së 2016-2025, SWOT, fq.15-17] Për shembull, analiza SWOT identifikon normat e pjesëmarrjes në rënie në projektet kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare. [RVV fq.42 & fq.42] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm do ta nxiste Universitetin për të adresuar pjesëmarrjen në rënie në projekte, në mënyrë që të mbështesë zhvillimin e fushave kyçe të punës. UBT-ja pranon se studiuesit e rinj janë një pjesë kyçe e komunitetit kërkimor. [RVV fq.49; M8 Studentët Pasuniversitarë] Strategjia e Zhvillimit të Universitetit thekson se duhen bërë më shumë përpjekje, për të përfshirë studentët e ciklit të dytë në kërkimin shkencor. [68 Strategjia e Zhvillimit të UBT-së 2016-25, SWOT, fq.16] dhe për të rritur cilësinë e futjes së studentëve të ciklit të tretë dhe për përshtatshmërinë e temave të tyre kërkimore me prioritetet institucionale. [68 Strategjia e Zhvillimit të UBT-së 2016-25, SWOT, fq.16] Prandaj, grupi sugjeron që Universiteti të vendosë përparësi në zhvillimin e kërkuesve të rinj dhe në përmirësimin e praktikave të kërkimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në mënyrë që të zgjerohet komuniteti kërkimor i Universitetit. [Kapitulli I Standardi II.8; Kapitulli I Standardi II.9; Kapitulli I Standardi II.12]

4.11 Universiteti lehtëson botimin e kërkimeve shkencore përmes përdorimit të faqes së vet të internetit dhe botimit të revistave të veta shkencore (Ekonomia dhe Agrobiznesi dhe Revista Shqiptare e Shk.Bujq) [RVV, fq.52] Universiteti pranon që zhvillimet e mëtejshme janë të nevojshme, për të promovuar profilin e tij të kërkimit, duke përfshirë shfrytëzimin e të gjitha kontakteve akademike për ndërtimin e rrjetit bashkëpunues; pajtueshmërinë ligjore me kërkesën për një bazë të dhënash kombëtare kërkimore; dhe rritjen e cilësisë së disertacioneve të doktoraturës. Kjo përbën një **dobësi**. [RVV, fq. 50-51] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që Universiteti të vendosë përparësi në promovimin e profilit të tij të kërkimit, në mënyrë që të shtojë mundësitë për stafin dhe studentët e angazhuar në kërkim [Kapitulli I Standardi II.11]

4.12 Universiteti i përmbush kryesisht standardet e cilësisë për mësimdhënie, mësimnxënie, vlerësim dhe kërkim. Metodatat e mësimdhënies dhe kërkimit janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e Studimeve Universitare dhe Strategjinë e Kërkimit Shkencor. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një sërë praktikash të mira duke përfshirë: angazhimin e stafit dhe studentëve dhe kontributin e tyre në një numër të madh projektesh dhe botimesh kombëtare dhe ndërkombëtare; kontributin e stafit kërkimor në projekte dhe kërkime që mbështesin interesat kombëtare të bujqësisë dhe eko-zhvillimeve; dhe

angazhimin në konferenca ndërkombëtare, që promovojnë fushat kyçe të kërkimit. Janë identifikuar dobësitë e mëposhtme: burimet e laboratorëve të mësimdhënies; zbatimi i vlerësimit; dhe promovimi i profilit kërkimor të Universitetit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që Universiteti të adresojë cilësinë e laboratorëve të mësimdhënies, të hetojë çështjet e vlerësimit të ngritura nga Anketimi i Studentëve dhe të promovojë profilin e tij kërkimor.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Kontributi i stafit kërkimor në projekte dhe kërkime që mbështesin zhvillimet mjedisore dhe ekologjike në lidhje me interesat ekonomike kombëtare (pika 4.8)
- Angazhimi i Universitetit në konferenca ndërkombëtare që promovon fushat kyçe të kërkimit (pika 4.9)
- Përfshirja e stafit të universitetit dhe studentëve në një numër të madh projektesh dhe botimesh kombëtare dhe ndërkombëtare dhe kontributi i tyre në to (pika 4.9).

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- burime të kufizuara në laboratorët e mësimdhënies (pika 4.1)
- zbatimi i procedurave të vlerësimit dhe feedback-ut (pika 4.4)
- zhvillime të mëtejshme që nevojiten për promovimin e profilit kërkimor të Universitetit (pika 4.11).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- të trajtojë cilësinë e laboratorëve të mësimdhënies për të mbështetur mësimin e bazuar në praktikë (pika 4.1)
- të hetojë çështjet e vlerësimit të ngritura nga Anketimi i Studentëve, për të siguruar vlerësimin e mëtejshëm (pika 4.4)
- të promovojë profilin kërkimor të Universitetit me qëllim shtimin e mundësive për stafin dhe studentët e angazhuar në kërkim (pika 4.11).

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi ndonjë veprim që po ndërmerret në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Gjykim

Standardet për Mësimdhënie, Mësimnxënie, Vlerësim dhe Kërkim janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

5.1 Universiteti ka një sërë sistemesh për menaxhimin e përvojës së të nxëniet të studentëve dhe ofrimin e mbështetjes për studentët nga faza para regjistrimit e deri në diplomim. Faqja e internetit e Universitetit ofron informacion për studentët e ardhshëm dhe palët e tjera të interesit. **[Faqja online e UBT-së: <http://ubt.edu.al/> Studentët M4 & M8, M6 Koordinatori i Institucionit]** Departamenti i Informimit, Orientimit dhe Karrierës së Studentëve është përgjegjës për menaxhimin e pranimeve të studentëve. **[141 Rektori Vendimi nr. 14, datë 1.4.2013]** Universiteti ka një politikë të qartë dhe të drejtë për pranimin e studentëve në programet e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë që mbështet aplikimet e studentëve, gjë që përbën **praktikë të mirë**. Zyra e Karrierës së Studentëve funksionon nën drejtimin e Departamentit të Informimit, Orientimit dhe Karrierës së Studentit dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon se konsolidimi i dy zyrave mbështet menaxhimin koherent dhe vënien në dispozicion e informacionit për studentët e rinj. **[93 Rregullorja për Zhvillimin e Kurrikulës, Karrierën dhe Vlerësimit Institucional; M7 Stafi Mbështetës]** Çdo vit akademik, Zyra e Karrierës së Studentëve përgatit paketat informative për të ndihmuar orientimin e studentëve të rinj, si dhe sigurimin e informacionit në faqen e internetit të Universitetit dhe informacionin për të mbështetur procesin e shkurtër të orientimit. **[166 Rektori Vendimi nr. 14; 93 Rregullorja për Organizimin dhe Funksionimin e Informimit të Studentëve; 150 Faqja online e UBT-së]** Zyrat e Karrierës së Studentëve (ZKS) janë të vendosura në çdo fakultet, duke punuar së bashku me zyrat e fakultetit dhe janë përgjegjëse për mbështetjen e studentëve dhe ofrimin e këshillave dhe udhëzimeve. **[141: Pika 4, e Vendimit të Rektorit Nr. 14; Stafi i Mbështetjes M9]** Stafi i Zyrës së Karrierës së Studentëve gjithashtu ndihmon në përgatitjen e udhëzuesit dhe fletëpalosjeve të Universitetit për ciklin e parë, të dytë dhe të tretë. Informacioni më i detajuar i programit vihet në dispozicion në internet, përmes faqeve të menaxhuara nga lektorë në mënyrë individuale. **[158 Faqja e internetit të pedagogëve; M10 Demonstrim IT]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** vlerën e udhëzuesve të vitit të parë të përgatitur nga Zyra e Karrierës së Studentëve, për të ndihmuar studentët e rinj të inkuadrohen në Universitet. **[Kapitulli I Standardi III.1]**

5.2 Studentët e ardhshëm janë në gjendje të marrin mbështetje dhe këshilla përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës, që gjithashtu shërben për të informuar aplikantët për programet e ofruara. **[93 Rregullorja për Organizimin dhe Funksionimin e Informimit të Studentëve; M4 Studentët]** Studentët gjithashtu janë në gjendje të marrin ndihmën e Qendrës së Këshillimit të Studentëve, që mbështet studentët në integrimin e tyre në Universitet. **[93 Rregullorja për Organizimin dhe Funksionimin e Informimit të Studentëve]** Dosjet e studentëve menaxhohen nga Sekretariati dhe ndjekin ecurinë individual të studentëve duke filluar nga regjistrimi e deri në diplomim. **[Stafi Mbështetës M9; Demonstrimi i IT-së M10; Kapitulli I Standardi III.1]**

5.3 Bazuar në propozimet e Universitetit, Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) miraton numrin e studentëve që do të pranohen çdo vit në programet Bachelor; Master i Shkencave, dhe Masterit Profesional, bazuar në propozimet e Universitetit. Kuotat a MAS bazohen në rezultatet e vitit të kaluar në universitetet dhe nga numri i kërkesave. **[75 Propozime për studentët e kuotave dhe tarifave të shkollimit 2015-2016]** Kriteret për pranimin e studentëve të vitit të parë në programin Bachelor janë konceptuar dhe menaxhuar nga Ministria. **[117 State (matura.akfq.gov.al)]** Deri në vitin akademik aktual, vendimet për pranimin e studentëve në programet e ciklit të parë janë menaxhuar ekskluzivisht nga Agjencia Kombëtare e Provimeve. **[M2 Rektori; M9 Stafi i Pranimeve]** Një Komision ad hoc për Masterin Profesional dhe Masterin e Shkencave i rendit aplikimet e studentëve bazuar në kualifikimet e mëparshme akademike dhe përdoren procese të ngjashme të përzgjedhjes

për pranimin e studentëve në programet e doktoraturës. **[160 Procesverbalet shtesë dhe deklaratat; M8 Studentët pasuniversitarë]** Rezultatet e vendimeve të pranimit të kandidatëve bëhen publike në faqen e internetit të Universitetit. **[124 Numri i studentëve sipas fakulteteve dhe kurseve]** Fakultetet krijojnë komisione ad hoc sipas nevojës, për të shqyrtuar ankimimet lidhur me pranimet dhe për të konfirmuar të dhënat e studentëve për pranim në programet e studimit, gjë që përbën **praktikë të mirë. [Mbledhja e 4 dhe 8 e Studentëve; Kapitulli I Standardi III.1]**

5.4 Pedagogët janë përgjegjës për menaxhimin e faqeve të tyre personale të cilat kanë akses studentë, përmes faqes së internetit të Universitetit. Llogaritë elektronike të stafit akademik dhe administrativ ofrohen përmes sistemit të komunikimit online ESSE3, i cili siguron një mjet të efektshëm komunikimi me studentët dhe me stafin universitar. **[158 Shembull i faqes së pedagogut; Stafi Akademik M7; M10 Demonstrimi IT 107 Lidhje ESSE3, Stafi Akademik M7]** Stafi është përgjegjës për të siguruar se informacioni që iu ofrohet studentëve është i qartë dhe i përditësuar. **[108 Faqja e internetit të pedagogut; M4 & 8 Studentët; M6 Koordinator i Institucionit; M7 Stafi akademik]** Sistemi gjithashtu mbështet komunikimet mbi aktivitetet më të gjera në të gjithë Universitetin, me stafin administrativ, kryesisht sekretarë, menaxhimin e informacionit në lidhje me vlerësimin e studentëve, njoftime për kërkime shkencore dhe projekte, si dhe menaxhimin financiar të Institucionit. **[M10 Demonstrim IT; Stafi Mbështetës M9; M4 & 8 Studentët]** Sistemi i komunikimeve elektronike shërben edhe si një mjet i efektshëm, për komunikim të brendshëm midis pedagogëve, studentëve dhe stafit mbështetës, duke përfshirë ofrimin e informacioneve formale dhe joformale për studentët sipas rastit. **[M7, Stafi akademik; Stafi Mbështetës M9; Kapitulli I Standardi III.2 & Kapitulli I Standardi III.6]**

5.5 Universiteti ka mekanizma efektive për të mbështetur përparimin akademik të studentëve. Studentëve iu jepet edhe një feedback për vlerësimet që marrin, **[158 Shembull i faqes së pedagogut; Stafi Akademik M7; M4 & M8 Studentët]** dhe stafi akademik ofron udhëzime studimore përmes materialeve të publikuara në faqet e tyre të internetit, duke përfshirë literaturë përkatëse për secilin modul. Zyra për Studime dhe Studentët dhe Qendra e Karrierës dhe Alumni ofrojnë informacion dhe udhëzime përfshirë çështjet e punësimit. **[44 EAF Informacion për Udhëheqjen e Studentëve; 93 Rregullorja për "Organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Zhvillimit të Kurrikulës, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional"; 121 Programi lëndor i Fakulteteve; 99 Rregullore e programeve të studimit "Doktoratë" të ciklit të tretë; M4 & 8 Studentët; M6 Koordinator i Institucionit; M7 Stafi Akademik]** Studentët janë gjithashtu kanë qasje në shërbimet e tutorimit dhe mund të kërkojnë takime me stafin mësimdhënës për mbështetje shtesë. **[7 Raporti i Analizës së Procesit Mësimor; 106 Shembull i planit të mësimdhënies dhe ngarkesës së modulit të mësimdhënies]** Marrëdhënia midis studentëve dhe stafit akademik mundëson komunikim dhe mbështetje efektive formale dhe joformale **[Kapitulli I Standardi III.3 & III.6]**

5.6 Informacioni i studentëve menaxhohet në mënyrë efektive dhe lidhet me ofrimin e mbështetjes. Dosjet e studentëve që mbulojnë periudhën nga regjistrimi deri në dhënien e një kualifikimi menaxhohen dhe ruhen nga Zyra për Studime dhe Studentët. Kontaktet elektronike të studentëve dhe detajet e telefonit regjistrohen, për të lehtësuar komunikimin në vazhdim. **[92 Rregullore për Zyrat e Studimeve dhe Studentët; M6 Koordinator i Institucionit]** Për të mbështetur më tej studentët, Senati miratoi krijimin e Qendrës së Karrierës dhe Alumni, e cila ofron këshilla dhe udhëzime për zhvillimin e karrierës dhe çështjet e punësueshmërisë. **[148 Vendimi i Senatit të UBT-së për themelimin e Qendrës së Karrierës dhe Alumni]** Kjo zyrë bashkëpunon me Departamentin e Informimit, Orientimit dhe Karrierës së Studentëve dhe Zyrat e Karrierës së Studentëve, për të ofruar shërbime

informacioni, udhëzime dhe këshillime për të gjithë studentët, dhe më së fundi për studentët e diplomuar. **[141 Vendimi i Rektoratit nr. 14, datë 01.4.2013; Vizita në terren; Stafi Mbështetës M9; M4 & 8 Studentët; Kapitulli I Standardi III.2]**

5.7 Universiteti ofron informacion dhe udhëzime për studentët që dëshirojnë të ndryshojnë programin e tyre të studimit. Universiteti gjithashtu ofron ndihmë të qartë për studentët e ciklit të dytë dhe të tretë për t'iu mundësuar atyre që të marrin pjesë në programet e shkëmbimit dhe periudhat e studimit jashtë vendit. **[M8 Studentët pasuniversitarë; Stafi Mbështetës M9; 51 Lista e projekteve]** Departamenti i Informimit, Orientimit dhe Karrierës së Studentëve dhe Zyrat e Karrierës së Studentëve ofrojnë informacion rreth mundësive për studime jashtë vendit, dhe në veçanti ato që lidhen me Projektin Erasmus, **[M8 Studentët pasuniversitarë dhe vizita në zyrat e karrierës]** përbën një praktikë të mirë. **[Kapitulli I Standardi III.3]**

5.8 Studentëve nga grupet minoritare iu ofrohet përkrahje në përputhje me kërkesat ligjore kombëtare, siç përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 911. **[22 Situata e pronave dhe objekteve të UBT-së; 71 Projekti i rampave dhe tualeteve]** Kjo mbështetje është e përqendruar te studentët me prejardhje nga familje me të ardhura të ulëta dhe nga grupet e pakicave, siç janë romët dhe studentët ballkano-egjiptianë. **[RVV fq.56; 118 Statuti; M3 Stafi i lartë drejtues]** Janë dhënë kuotat e regjistrimit që përjashtojnë grupe të veçanta nga pagimi i tarifave të studimit. Rampat janë siguruar në disa ndërtesa për të lehtësuar lëvizshmërinë e studentëve me aftësi të kufizuara **[71 Projekti i rampave dhe tualeteve; 75 Propozime për kuotat e studentëve dhe tarifatat e shkollimit]** Ka pak dispozita specifike për studentët me probleme fizike ose të tjera, përveç atyre që ofrohen brenda komunitetit vendor. Bashkëpunimi i mëtijshëm me ofruesit e shërbimeve shëndetësore vendore do të rriste sigurimin e mirëqenies **[Vizita në terren; Stafi Akademik M7; Kapitulli I Standardi III.8]**

5.9 Universiteti ofron mbështetje për studentët që të angazhohen në aktivitete sportive. Për shembull, Fakulteti i Shkencave Pyjore ka ngritur një sallë sportive për "ping-pong" dhe në fillim të vitit akademik organizohet kampionati i futbollit të fakultetit. Në vitet 2014 dhe 2015, ekipi i studentëve të Universitetit garoi kundër 12 institucioneve të tjera në një aktivitet të sponsorizuar nga Klubi Studentor në bashkëpunim me Drejtorinë e Sporteve në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. **[17 fotografi nga veprimtaria sportive; 21 fotografi të sallës së Ping-Pong; 137 Vendimi i pagesës së studentëve që marrin pjesë në aktivitete sportive; Stafi i lartë drejtues M3; M9 Stafi mbështetës]** Janë organizuar ndeshjet e shahut dhe një student arriti vendin e tretë në një konkurs kombëtar. **[Stafi i lartë drejtues M3; RVV fq. 61-62; 79 Raporti për Panairin e Karrierës për vitin 2015]** Universiteti gjithashtu kërkon të mbështesë jetën kulturore të studentëve përmes panairëve, konferencave, turneve çlodhëse dhe aktiviteteve sportive. **[79 Raport për Panairin e Karrierës për vitin 2015, UBT; Kapitulli I Standardi III.8]**

5.10 Nëpërmjet bibliotekës kryesore universitare, të cilat kanë një burim prej rreth 20.000 titujsh dhe 5.000 buletinesh dhe revistash, studentëve u ofrohet një sasi e përshtatshme materiale online, tekste akademike dhe materiale të tjera të shtypura. **[M2 Rektori; Stafi Mbështetës M9; Vizita në terren; 32 Lista e pasurive të paluajtshme]** Gjithashtu ka biblioteka të vogla për lëndët specifike. **[65 Ndërtesa dhe Planet e Kampusit; 125 Tabela përmbledhëse e objekteve universitare]** Për shembull, ndërtesa e re e Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit ka bibliotekën e vet, që ofron pajisje moderne përfshirë edhe lidhjen në internet, nëpërmjet 12 kompjuterëve me akses në "The Essential Electronic Agricultural Library" (TEEAL), një bazë të dhënash me 200 nga revistat më të mira në botë për bujqësinë dhe mjedisin. Kjo mundësi aksesit është produkt i bashkëpunimit me Universitetin

e Hawaiiit, SHBA. **[52: Marrëveshja me Universitetin e Hawaiiit; Vizita në terren; 125 Tabela përmbledhëse e objekteve universitare]** Kontaktet mbahen dhe zhvillohen me bibliotekat kombëtare dhe ndërkombëtare për të përmirësuar burimet në dispozicion. **[M2 Rektori; Stafi i lartë drejtues M3; M9 Stafi Mbështetës]** Gama e gjerë e librave dhe revistave të aksesueshme për studentët, që mundësohen në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera në mënyrë efektive mbështet mësimin e studentëve dhe përbën një **praktikë të mirë. [Kapitulli I Standardi III.5]**

5.11 Çdo lëndë ka një listë të materialeve referuese të cilat përditësohen nga Departamenti i Standardeve dhe Kurrikulave. **[Stafi akademik M7; Stafi i lartë drejtues M3; RVV fq. 57]** Literatura e re blihet çdo vit në bazë të propozimeve të kërkimit shkencor nga departamentet individuale. **[42 Dokumenti mbi Buxhetin e UBT-së]** Studentëve u ofrohen udhëzime nga udhëheqësit/pedagogët, veçanërisht në lidhje me punën e tyre kërkimore. **[M8 Studentët pasuniversitarë; Stafi Akademik M7; 121 Programet e Fakulteteve]** Materialet e mëtejshme janë në dispozicion përmes faqeve të pedagogëve. **[30: materiale me pamje nga ekrani i kompjuterit; M4 Studentët, M6 Koordinatori i Institucionit]** Megjithatë, biblioteka është e hapur vetëm nga ora 08.00 deri në orën 16.00, që e kufizon qasjen për stafin dhe studentët pas orareve të leksioneve. Universiteti mund të dëshirojë të marrë parasysh zgjatjen e orëve të hapjes për të mundësuar aksesin më të madh për stafin dhe studentët. **[Kapitulli I Standardi III.5 & Kapitulli I Standardi III.6]**

5.12 Universiteti është në përputhje me kornizën ligjore për arsimin e lartë. Studentët janë të përfaqësuar në strukturat funksionale të Universitetit duke përfshirë Senatin, Bordet e Menaxhimit, Komitetin e Mësimdhënies dhe Komitetin e Etikës, dhe janë në gjendje të japin feedback mbi mbështetjen për kurrikulën, mësimdhënien dhe studimet. **[118 Statuti, Vendimi i IEC dhe i FEC; 100 Statuti i Universitetit, Kapitulli V / Neni 57; M4 & 8 Studentët; Kapitulli I Standardi III.7]**

5.13 Qendra e Karrierës dhe Alumni siguron materiale për mundësitë e karrierës dhe mban të dhëna për punësimin e studentëve. Zyra punon për të forcuar lidhjet me kompanitë private dhe publike në sektorin e prodhimit bujqësor dhe ushqimor dhe për të zhvilluar marrëveshje të nënshkruara me punëdhënësit që mbështesin praktikën dhe aftësitë e bazuara në praktikë. **[93 Rregullorja për “Organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Zhvillimit të Kurrikulës, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional”;** **Stafi i lartë drejtues M3; 104 Shembull i marrëveshjes me bizneset]** Qendra e Karrierës dhe Alumni organizon një panair vjetore të punësimit, duke ftuar punëdhënësit nga industrinë që lidhen me fushën, veçanërisht nga fusha e agrobiznesit, për t'u takuar me studentët. **[79 Raporti i vlerësimit për panairin e karrierës: Dëshmia 103: Shembull i një ftese të Qendrës së Karrierës dhe Alumni për bizneset]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi panairin e punësimit, i cili i sjell studentët në kontakt me tregun e punës, si një praktikë të mirë. Aftësitë e punësimit janë zhvilluar gjithashtu përmes një Moduli të Menaxhimit të Karrierës që ofrohet nga fakultetet dhe realizohet nga profesorët për studentët e ciklit të parë. Moduli u ofron studentëve aftësitë dhe kuptueshmërinë e nevojshme për t'i ndihmuar ata të gjejnë punë dhe të ndërtojnë një karrierë. **[45 Programi lëndor për Modulin e Menaxhimit të Karrierës; M. 7 Stafi Akademik & Mbrojtës]** Marrëveshjet e nënshkruara me bizneset vendore ndihmojnë që studentët e ciklit të parë të kenë mundësi të përfitojnë përvojë pune. **[104 Shembull i një marrëveshjeje që është nënshkruar nga UBT-ja dhe bizneset; M5 partnerët e jashtëm, këshilltarët dhe punëdhënësit]** Shtirja e angazhimit të punëdhënësve për të përfshirë praktikën dhe mundësitë për të mbështetur ofrimin e studimeve pasuniversitare do të rriste më tej mundësinë e punësimit të studentëve.

5.14 Universiteti ka sisteme dhe zyra efektive për t'u ofruar studentëve mbështetje dhe këshillim duke filluar nga faza e regjistrimit e deri tek gjetja e punësimit. Praktikët e mira të identifikuar përfshijnë: proceset e qarta dhe të drejta të pranimit që mbështesin aplikimet e studentëve; komisionet ad hoc që shqyrtojnë ankimimet për pranimet; mundësi për studentët për të studiuar jashtë vendit; gamën e gjerë të burimeve të bibliotekës; dhe panairë vjetore të punësimit, që mbështesin punësimin e studentëve. Praktika e efektshme në mbështetjen e studentëve të ciklit të parë për praktikën profesionale dhe stazhin bazuar në marrëveshjet e nënshkruara me punëdhënësit, mund të shtrihet për të përfshirë nivelin pasuniversitar. Zgjatja e orarit të hapjes së bibliotekës do të rriste aksesin në burime. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi gamën e materialeve informative të ofruara, duke përfshirë udhëzuesit për studentët e rinj të përpiluar nëpërmjet punës së konsoliduar të Departamentit të Informimit Orientimit dhe Karrierës së Studentëve dhe Zyrës së Studentëve dhe Karrierës, të cilat i mbështesin studentët për t'u integruar në Universitet.

Gjetjet

Praktikë e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Procesi i qartë dhe i drejtë i pranimit të Universitetit i cili mbështet aplikimet e studentëve (pika 5.1)
- Ngritja e komisioneve ad hoc sipas nevojës, për të shqyrtuar ankimimet e pranimeve dhe për të konfirmuar të dhënat e studentëve për pranim në programet e studimit (pika 5.3)
- Departamenti i Informimit, Orientimit dhe Karrierës së Studentëve dhe Zyrat e Karrierës së Studentëve ofrojnë informacion rreth mundësive për studime jashtë vendit, veçanërisht lidhur me projektin Erasmus (pika 5.7)
- Gama e gjerë e librave dhe revistave në dispozicion në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera, në mënyrë efektive mbështet të nxënësit e studentëve (pika 5.10)
- Panairë vjetore të punës që i sjellin studentët në kontakt me tregun e punës dhe mbështesin punësimin (pika 5.13).

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk ka bërë asnjë rekomandim në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon se veprimet e mëposhtme po ndërmerren aktualisht:

- konsolidimi i dy zyrave (Zyra e Karrierës së Studentëve dhe Departamenti i Informimit, Orientimit dhe Karrierës së Studentëve) mbështet menaxhimin koherent dhe nxjerrjen e informacionit për studentët e rinj (pika 5.1)

- vlera e udhëzuesve të vitit të parë të përgatitur nga Zyra e Karrierës së Studentëve për të ndihmuar studentët e rinj të integrohen në Universitet (pika 5.1).

Gjykim

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht.